



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 060/01-4294/26  
Kaçanik, 26.02.2026

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II (dytë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2026 (Legjislatura e 8), mbajtur me 26.02.2026 (e enjte), në katin e tretë, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga Kuvendi i Komunës prej 21 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 20 anëtarë, në ndërkohë arriti, Lejla Çaka Muhaxheri, pjesëmarrës janë 21 anëtarë-të gjithë. Nga Ekzekutivi i komunës morën pjesë: Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Nënkrjetari i Komunës -Xhelal Dema, drejtorët: Korab Krasniqi-DUKMM, Valdrin Dogani-DBF, Arian Teneqja-DSHPE, Suhad Dullovi-DBPZHR, Urata Sopa-DAP, Lumnije Demnika Selmani-DSHMS, Arlinda Rakoci Raka-DZHET, Gazmend Bunjaku-DA, Lulzim Krasniqi-DKRS. Nga zyrtarët: Bejtulla Dalloshi, Fatlume Guri-Selimi, Arianitë Bajrami, Mavije Murseli.

Mbledhja monitorohet nga distanca nga zyrtari i MAPL, Nehat Uka. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Arianitë Bajrami

**Kryesuesi i Kuvendit - Selajdin Troni:** Së pari i përshëndeti të gjithë të pranishmit, iu dëshiroi mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushtet pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e II-të të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2026 të Legjislaturës së 8, data 26.02.2026, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i punës i Ekzekutivit të komunës për vitin 2025;
3. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025;
4. Raporti vjetor i Njesisë së Auditimit të brendshëm, për vitin 2025;
5. Informatë për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor 2025-2026;
6. Propozim Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Faik (Rufat) Muça;
7. Propozim Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Isen (Agush) Raka;
8. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik të parcelave kadastrale në Z.K Koxhaj, në Z.K Soponicë dhe Z.K Stagovë (**hiqet**);
9. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik të parcelave kadastrale në Z.K në Kaçanik dhe në Z.K Bob;
10. Raporti për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara të reshurat e borës 02.10.2025 dhe të reshurat e shiut 24,25.11.2025;

10.1 Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit mbi vlerësimin e dëmëve të shkaktuara nga reshjet e borës në Llanishtë, të fermeres Ramize Axhami;

10.2 Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit mbi vlerësimin e dëmëve të shkaktuara nga reshjet e borës në Stagovë, të fermerit Hajdin Teneqja;

10.2 Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit mbi vlerësimin e dëmëve të shkaktuara nga reshjet e shiut në Bob, të fermerit Heset Kuka;

11. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026;

12. Kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës - AKK, për emërimin e delegatëve në Kuvendin e AKK.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin, nuk u paraqit kush, rendin e punës e shtroj në votim, i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Konstatohet se Kuvendi i Komunës,

#### **Aprovoj**

**Rendin e punës sipas evidencës me heqjen e pikës 8.**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja I-r e rregullt e KK, e legjislaturës së 8, për vitin 2025;

**znj. Kadrije Lika Troni:** Në f.9, të formimi i komisionit për KRM “Pastërtia, nuk kam thënë se është konflikt interesi që ka dhënë 2 propozime Bashkimi, por kam thënë pikërisht është konflikt interesi, dihet së Bashkimi është vëllai i pronarit që operon në kuadër të KRM “Pastërtia”. **Pasuesi “me i dhënë dy propozime” -Hiqet.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Me këtë ndryshim, Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KK u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Konstatohet se Kuvendi i Komunës

#### **APROVOJ**

**Procesverbalin nga mbledhja I-r e rregullt e KK, e legjislaturës së 8, për vitin 2026, të datës 30.01.2026/ Lënda: 01Nr. 060/01-1776/26. Procesverbali do të publikohet në faqen zyrtare të komunës i korrigjuar.**

#### **Pyetjet dhe Kërkesat**

**z. Jeton Luma:** Kërkesa ime ka të bëjë me një pyetje të cilën e ngrita në mbledhjen e kaluar, ju drejtova kryetarit dhe drejtorit përkatës të DSHPE- Arian Teneqja, për ndriçimin publik në Gllboçicë, 75% e fshatit janë pa ndriçim publik. Kryetar, a mundeni me i kaluar këto procedurat 1-2 muaj dhe me marrë një përgjigje nga ana e juaj, Çka do të bëhet me ndriçimin publik në nivel të komunës, me theks të veçantë në f. Gllboçicë?

**z. Heset Malsiu:** Paraqiti një kërkesë të banorëve të lagjes “Çardaku” të Kaçanikut të Vjetër, për lejimin e shfrytëzimin e një parcele afër varrezave, për parking të automjeteve, gjatë ceremonive të varrimit. Kërkesën e lagjes e vlerësoj shumë e arsyeshme, pasi komunikacioni do të jetë me pak i ngarkuar në raste të varrimit.

**znj. Ernesta Krasniqi:** E ngriti shqetësimin për vonesat në përgjigjet ndaj pyetjeve dhe kërkesave të anëtarëve të KK dhe kërkoi që ato të mos vonohen me tepër se 1 muaj, se po i humb vlera përgjigjes, siç e potencoj edhe kolegu im. Kërkoj nga Kryesuesi të shtyjë përpara shqetësimin tonë- të ekzekutivi, që përgjigjet mos me u vonuar me tepër se 1 muaj.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sa e di unë, shumica e përgjigjeve janë kthyer. Ata të cilët nuk kanë dhënë përgjigje, është mirë me iu përgjigjur pyetjeve dhe kërkesave.

**z. Korab Krasniqi:** Unë Erestës ia kam dërguar përgjigjen në dy emaillet, përgjigjen në kopje fizike e kam këtu.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Grupi i jonë i anëtarëve të KK nuk e ka marrë asnjë përgjigje. Nëse ka kush që i ka marrë përgjigjet, atëherë na tregoni emailin.

**z. Valdrin Dogani:** Jeton Luma me ka dërguar direkt një pyetje në emailin tim, unë ia kam kthyer përgjigjen.

**z. Jeton Luma:** Pyetjen e kam ngritur për ndriçimin publik në Gllloboçicë, përgjigje nuk kam marrë. Mund të jetë ndonjë gabim teknik, e bisedova me herët me drejtorin, drejtori e din që unë jam për herë të parë anëtar i KK. Materialin e mbledhjes e kam marrë në email privat, ndërkaq nuk kam pranuar ndonjë email zyrtar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nga muaji i ardhshëm, përgjigjet do të dërgohen përmes zyrtares së kuvendit, që të kenë qasje të gjithë anëtarët.

**znj. Hafize Sallahi:** Për mbledhjen e parë e kam marrë ftesën dhe materialin, për këtë mbledhje jo, mund të jetë bërë ndonjë gabim teknik.

**znj. Ardita Rrahmani:** Kërkoj me u rritur kapaciteti i emaileve, se janë stërmbushur. Kërkesë tjetër, Përgjigjet i dërgoni të zyrtarja e KK dhe përmes saj, njoftohemi ne.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Ftesa për mbledhje nuk na vjen në email zyrtar, se nuk ka kapacitete. E kemi biseduar edhe me zyrtaren e KK këtë çështje.

**Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi:** Përgjigjet në pyetje dhe kërkesa, janë dhënë, problemet me emaile janë diçka tjetër. Ne dërgojmë përgjigjet në emaile zyrtare, e jo në mesingjer. Këtë të dinë të gjithë qytetarët se përgjigjet janë dhënë nga secili sektorë.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kryetar, mos manipuloni me qytetarë. Përgjigjet ne nuk i kemi marrë. Në mbledhjen e KPF kemi kërkuar rritjen e kapacitetit të emaileve zyrtare.

**z. Islam Gashi:** Parashtroj kërkesë për krijimin e hapësirave për aktivitete sportive për të rinjtë në f. Begracë. Parashtroj pyetje: A është paraparë nga Ekzekutivi, Ndërtimi i një fushe sportive në f. Begracë? Nëse po, kur fillon realizimi? Nëse nuk është paraparë, kërkoj të merrni veprime të nevojshme për ndërtimin e një terreni sportiv në Begracë, se fshati është i madh me 2000 banorë rezident, mbi 50% janë nën moshën 29 vjeçare.

**z. Buletin Guri:** Parashtroj kërkesë për krijimin e një pike të grumbullimit të qumështit për fermerët që merren me këtë veprimtari. Transporti i qumështit në komunat tjera, ka kosto të lartë dhe ndikon në rritjen e faktorëve të prodhimit. Propozoj të shqyrtojmë edhe si komunë, krijimin e një skeme mbështetëse, për fermerët që arrijnë standarde të caktuara të cilësisë së qumështit, që të përfitojnë subvencion shtesë për litër qumësht prej 5-10 cent, varësisht nga standardi i prodhimit të qumështit. Ekzekutivi i komunës, nuk duhet të justifikon me përgjigje klasike, se nuk ka buxhet, buxheti me tepër është çështje e prioriteteve, etj. Nëse ka vullnet politik, ka zgjidhje të problemeve. A ka mundësi drejtori me dhënë përgjigje mua direkt apo fermerëve se kur do të subvencionohet litri i qumështit në komunën e Kaçanikut?

**znj. Kadrije Lika Troni:** I bashkëngjitem kolegëve, pyetjet dhe kërkesat ti pranojmë nga zyrtarja e KK, për me ditur përgjigjen të gjithë, e jo me qenë kontakti drejtor- anëtar i KK. I kam dy kërkesa për, DSHPE dhe DA. Na gëzon fakti që kryetari Sabedin Vishi ka realizuar disa kërkesa tona të ngritura në mandatin e kaluar.

1. Subvencionimi i nxënësve të shkollave të mesme po bëhet pa përjashtim, përfshirë edhe shkollën "Skënderbeu", ndërkaq ka mbingarkesë të autobusëve, përveç nxënësve, udhëtojnë edhe qytetarët tjerë, nxënësit shpesh ngelin në këmbë. Në shumë raste tejkalohet numri i ulëseve, duke krijuar pakënaqësi dhe rrezik për sigurinë e tyre. Subvencionimi i transportit

të nxënësve, nuk duhet të mbetet vetëm vendim formal, por të shoqërohet me organizim të mirëfilltë. Nxënësit kanë të drejtë të udhëtojnë në kushte të sigurta dhe dinjitoze, pa u trajtua si pasagjer të dorës së dytë. Kërkoj nga ekzekutivi dhe organet përgjegjëse të rishikojnë çështjen e transportit të nxënësve, të sigurojnë mjete të mjaftueshme të dedikuara për nxënësit, të shmanget mbingarkesa dhe të garantohet siguria e tyre. Vetëm kështu ky vendim do të ketë kuptim të plotë dhe do të shërbejë realisht interesit të qytetarëve, e në këtë rast mirëqenies së nxënësve.

2. Kërkesë për pastrimin e lumenjve, sidomos lumit lepenç, pjesa të ura ku frekuentohet nga shumë vizitorë të qyteteve tjera, pasi në njërin anë është, Palestra sportive në anën tjetër Stacioni i autobusëve, kërkesë kjo të cilën e kam ngritur edhe në mandatin e kaluar, nuk është marrë asgjë. Ekziston një pemë të ura, ku i janë dashur vite të tëra me lëshuar rrënjë nga lumi dhe zhvillimi i saj ka arritur të kaloj mbi urë. Kërkoj nga ekzekutivi, DSHPE të merr parasysh këtë kërkesë.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë isha skeptike, a me ngritur tani çështjen e shkollës "Emin Duraku" apo të Informata.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Vazhdoni Ardita të pyetjet dhe kërkesat.

**znj. Ardita Rrahmani:** Shqetësimi im i ripërsëritur-temë e shtjelluar disa herë në legjislaturën e kaluar, Ndërtimi i objektit të ri të shkollës së re "Emin Duraku" në Kaçanik, ku secili nga ne, ata që po na përcjellin, e dinë që është objekti fizikisht me vjetri, me i dëmtuari në komunën tonë. Investimi i vetëm është bërë në vitin 2001, aq sa e kam pa në materialin e përgatitur nga drejtori, të cilit i jam falënderues, mandej është bërë renovim kohë pas kohe sipas nevojës. Është nevojë imediate me ndërhyrë në ndërtimin e objektit të ri të shkollës, kjo dihet tek se është buxhetua, si kod ekziston dhe bartet vit pas viti tash e katër vite, me buxhetin e MF. Si nuk mund të shihet prioritet kjo shkollë, të buxhetohet me një kod të vetëm 3 shkolla, e ndahen vetëm 800 mijë euro? Kostoja e ndërtimit të kësaj shkollë në vitin 2021 ka qenë 3.5 milion, tani është shumëfishuar në 5.706 milion. Pyetje, për ata të cilët e mbajnë vetën përgjegjës për mos kalimin e amendamentit të kërkuar, në seancën e fundit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për futjen në buxhet në kod të veçantë ndërtimin e shkollës "Emin Duraku". Pse ky amendament nuk ka kaluar? Kush e mban vetën përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti? Ju bëj me dije se ne nuk kemi me heshtur. kemi me qëndruar stoik, duke kërkuar ndërtimin e atij objekti. Ata të cilët premtojnë, është mirë me i mbajtur premtimet dhe me i realizuar, për arsye se ne këtu kemi me qenë edhe për 4 vite. I kam këtu 6 kopje, po ia dërgoj secili shef të grupit, për me pa se kush ka votuar kundër amendamentit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore "Emin Duraku" në Kaçanik.

**z. Kjani Zeneli:** Unë jam sqaruar pak me kryetarin dhe me drejtorin e Arsimit. Në mbledhjen e kaluar, Bashkim Krasniqi e bëri një kërkesë për subvencionimin e nxënësve që udhëtojnë jashtë komunës së Kaçanikut, drejtimit të Mjekësisë dhe disa drejtime tjera të veçanta. Ajo kërkesë si duket ishte sa me fol diçka, ndërkaq realizimi ishte i pamundur. A ka mundësi me u gjetur ndonjë modul, që edhe ata nxënës të ndihet të barabartë me nxënësit tjerë. Përgjigjen nuk kemi marrë lidhur me këtë pyetje.

2. Raporti i punës i Ekzekutivit të komunës për vitin 2025;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika Troni:** 1. Të projektet kapitale, Projekti i ndërtimit të shkollëve, punimet kanë filluar në vitin 2025, siç po shihet, projekteve të dështuara të komunës po i shtohet edhe ky projekt. Pyetje për Kryetarin, pasi ka qenë pjesë e ekzekutivit: Pse ka ardhur deri të shembja e dheut në atë pjesë, është bërë i pamundur kalimi i vizitorëve. Gjatë mandatit të

kaluar, ne vazhdimisht kemi kërkuar të bëhet fizibiliteti i tokës, inspektimet e punës së punë-kryesit. Projekti është në vlerë 220 mijë euro. Në vend që sot të flasim për projektin e kryer, duhet të flasim për projektin e dështuar.

2.Pyetje për DBF: Këtu në raport të ekzekutivit dhe në raportin e financave, nuk munda me gjetur subvencionimin e bursave. Përmenden subvencionet, por vlera sa është nuk paraqitet në raport. Pyetje për drejtorin apo Kryetarin: Sa ka qenë numri i përfitueseve të bursave ?

**znj. Ernesta Krasniqi:** 1.Të sjajdi 40, f.39 është një tabelë e pakuptueshme, tregon për rrugë të asfaltuara, shënon rruga Dubravë, Begracë, Kaçanik i Vjetër, nuk e kuptojmë për cilat rrugë kanë të bëjnë asfaltimi, sa ka kushtuar metra e gjatësisë, që janë shtruar me asfalt, zhavorr dhe kubëza? Tjetra, rrugët e shtruara për metër gjatësi, është shënuar në total 2114m, ndërkaq nëse i kalkulojmë shifrat në tabelë na del 1979m gjatësi, nuk e di a është gabim teknik në raportin e ekzekutivit f.39, sjajdi 40. Në sllajdin 42, f.49 shënohet, për vitin 2025 janë paraparë investime për projekte, 1 milion e 160 mijë euro, realizuar, 751 mijë euro, është shqetësuese realizimi kaq i mangët i projekteve. Në sllajdin 56, f.55, Pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe veteranëve të UÇK, thuhet në raport se mirëmbahen dhe para çdo date të rëndësishme, pastrohen dhe mirëmbahen pllakat përkujtimore në lokacione të ndryshme. Raporti është me treguar një gjendje reale e jo të dëshirueshme. Fatkeqësisht varrezat e dëshmorëve nuk mirëmbahen para datave të rëndësishme. Nuk e di a është e rëndësishme data 17 shkurti 2026, që me pa se a janë mirëmbajtur dhe pastruar pllakat përkujtimore. Në hyrje të qytetit të rrethi, ku janë shkronjat UÇK, flamujt janë të copëtuar, kjo nuk është gjë e mirë, sidomos para festave. Në sllajdin 72, f.71 është, Ndërtimi i kioskave për biznese, ku janë këto kioska -aset i komunës, për çka janë përdorur, sepse tani për tani në qytet nuk shohim se ka ndonjë kioskë?

**z. Hestet Malsiu:** Edhe mua me kanë bërë përshtypje, jo vetëm tabelat të cilat i përmendi kolegja, por edhe tabelat paraprake, janë 5 mijë metra apo 5km me shumë shtrim të rrugëve sesa që kalkulohet për rrugët që janë shtruar. Në njërin anë shihet se ka pasur suficit, ndërkaq në anën tjetër, shihet se janë shtruar rrugë me gjerësi 3m. Prej 1568m gjatësi rrugë urbane, 1413 janë me gjerësi 3m, ndërkaq 155 janë me gjerësi mbi 3m, 95 janë me 4.5m, 65m janë me 6m gjerësi. Tjetra, të rrugët rurale, shënohet rrugë të asfaltuara 8098 metër gjatësi, me 3m gjerësi janë 5077m, ndërkaq 965m rrugë janë me 4m gjerësi, që i bien as 1/3. Kur e pash se rrugët shtrohen 90% me vetëm 3m gjerësi, kjo është për mua me pa se cili ka qenë mentaliteti qeverisës. Rrugët e parapara të shtruara me zhavorr 4m gjerësi, që nuk i kam kalkuluar, që i bien se ato rrugë nuk do të shtrohen mbi 3m gjerësi. Nuk ka zhvillim kështu dhe nuk ecet përpara në këtë formë. Uroj që mentaliteti qeverisës të ndryshohet, kam pa disa ndryshime që janë pozitive, si nuk i vjen më era qebaptore dhe era flija komunës, uroj të vazhdohet edhe me gjera tjera me të mira të komunës.

**Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi:** Raporti është voluminoz, në secilin dikaster në veçanti, janë realizuar një numër bukur i madh i projekteve në përputhje me buxhetin që kemi pasur, ka raste kur kemi qaluar, jemi përballë me sfida për shkak të kontratës kolektive mbi 1 milion euro për procese gjyqësore. Të pyetjet konkrete, të Guri i shpuar- të shembja, pse është shembur? Në një kohë kur ka pasur shumë të reshura, jo vetëm në Kaçanik, por janë përballur me sfida me të mëdha si në Kosovë, Shqipëri dhe vende tjera. Mund të ndodhë që shembën, i ka ndodhur edhe Bektel Enka, kur e ka pasur 10 milion euro një metër kur iu ka shembur shtylla, por ka garanci kjo, se nuk është përfunduar ende puna, e heq dheun, e pastron dhe e kthen në gjendje të mëparshme. Nuk mundet të quhet projekt i dështuar, ata që e quajnë nuk e di se ku bazohen, bile sivjet mendohet me u bërë lidhja deri të shkronjat e arta të UÇK, me përmbyllë si projekt për turizëm dhe atraksion dhe ku

krenohet edhe me historinë komuna e Kaçanikut. Guri i shpum ka histori të veçantë, aq me tepër kur mbërrimë të ballkoni panoramik ku janë tre shkronjat arta, e falënderoj OVL në bashkëpunim me komunitat dhe disa kompani që i kanë realizuar këto shkronja, për të cilat mburremi se është lavdia me e madhe e Kosovës. Të çështja e bursave, është rritur numri i bursave nga 50- 60 bursa, me tepër sesa është premtuar. Të rrugicat, raporti është në total me metra apo kilometra. Nëse ka ndonjë gabim teknik, kërkoj falje, nëse doni me pa në detaje, mundeni me bërë kërkesë për qasje, ato janë projekte që prekën e shihen. Sa i përket gjerësisë dhe gjatësisë, pajtohem që 3m ndoshta nuk janë të mjaftueshme. Sa i përket pyetjes sa kanë kushtuar, janë të dhënat në prokurim, hynë të faqja e komunës, janë të dhënat se unë nuk merrem me atë punë, drejtoni me kërkesë drejtorit, i merrni të dhënat.

Mirëmbajtja e varrezave, është e pavërtetë që thuhet se nuk mirëmbahen. Është Kjanu këtu, dhe e din se para çdo aktiviteti, edhe kur kam qenë nënkryetar, e përgëzoj edhe OVL për punën, se nuk ka vend që nuk e kemi pastruar të varrezat e dëshmorëve. Kemi kontratë të veçantë për mirëmbajtje të rregullt, mirëmbajtje të rregullt ka edhe parku, ku janë dy shtatorët e komandantëve të UÇK. Mundemi tani me shkuar me i pa, gjendja nuk është ashtu si thoni. Flamujt të rrethi i UÇK nuk janë të shqyer, janë të ndërruar. Të kioskat nuk ka përfunduar ende kontrata, ato pozicione që janë ndërtuar, janë paguar, pritët shumë shpejtë me i vendosur. Është formuar një komision që del edhe në bulevard dhe në sheshin e qytetit, kanë me u vendosur dhe shumë shpejt do të shihni realizimin e këtij projekti. Të rrugicat, 3 metra apo 4 metra, ka ndodhë që në zona urbane ka pasur mure në dy anët e rrugës, dhe për shkak të buxhetit, diku janë 3.5 metra. Për 4 vjet kemi realizuar shumë projekte, projektet nuk janë të dështuara. Me thoni mua, cilin projekt e keni sjellë nga qeveria? Në vazhdim Kryetari kërkoj të mos i ndërhyjnë gjatë dhënies së përgjigjeve të cilat u ngritën.

**znj.Kadrije Lika Troni:** Kryesues, në momentin që unë e bëjë pyetjen, e dua përgjigjen interaktive, se nuk është ky komunikim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ju po doni bashkëbisedim? Nuk është në rregull forma interaktive.

**znj.Kadrije Lika Troni:** Po, ne për atë jemi këtu. Unë po dua para qytetarëve me u dhënë përgjigjet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mos ndërhyjnë në diskutim.

**znj.Kadrije Lika Troni:** Unë nuk pajtohem me rregullin dhe qasjen qysh e keni krijuar ju kryesues, këtë praktikë duhet me ndryshuar. Pyetjen kur t'ia bëjë, drejtorit apo kryetarit, dua me mu përgjigjur menjëherë.

**Kryetari i Komunës:** Nuk ka problem edhe në formë interaktive mundem me u përgjigjur. Unë e pata me kursyer kohën, përndryshe i përgjigjem secilit veç e veç. Unë në fillim kërkoja që me i marrë fillimisht të gjitha pyetjet, ishte njëfarë aprovimi. Për hera tjera, Kadrije sa herë që bënë pyetje, të përgjigjem menjëherë, dhe secilit që bënë pyetje. Unë iu përgjigja të gjitha pyetjeve që u ngritën në raport.

**znj. Ardita Rrahmani:** Ky kuvend nuk është i një individi, por i të gjithë neve. Rregullat për individ, duhet me shërbyer njëjtë për të gjithë, ose individi me u pajtua me rregullat e përgjithshme. Në të kundërtën e ndryshojmë rregulloren, e diskutojmë qysh me vepruar në seancat tjera, por çështja është se deri sot kemi funksionuar kështu. Për mua është në rregull forma interaktive, por duhet të diskutojmë këtë formë.

**z. Buletin Guri:** Pyetje për Kryetarin: Të Investimet në infrastrukturën shkollore, pika 4.1, f.29, janë bërë renovime në shkollat: SHFMU” Emin Duraku”- në Dushkajë, “Idriz Seferi”- Bob, “Nazmi Osmani” -Elezaj, janë shpenzuar 30 mijë euro nga buxheti i komunës. Ndërsa të pika tjetër e shoh se para fillimit të vitit të ri shkollor, SHFMU “Jusuf Gërvalla” në f. Nikaj, është bërë lryja e sipërfaqes së brendshme të objektit shkollor, janë kryer edhe disa

renovime në hapësirën e jashtme shkollore. Vlen të potencohet se ky aktivitet është bërë me mjete dhe punë vullnetare nga banorët e fshatit Nikaj. Për 3 shkolla për renovime janë shpenzuar 30 mijë euro, ndërkaq për shkollën e f. Nikaj, detyrohen prindërit e nxënësve të vetëfinancojnë në renovimin e shkollës. Edhe sa kohë duhet kryetar me qenë kaq selektiv ndaj banorëve të f. Nikaj?

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kryesues, nuk jeni i barabartë, kur diskutojmë ne, e ndërpreni diskutimin, ndërkaq këtu diskutohen tema të Kuvendit të Kosovës, ju heshtni. Këtu duhet të diskutojmë për qeverisjen lokale, jo për qeverisjen qendrore. Ju Ardita po doni me marrë vëmendjen sikurse deputetja në Republikën e Kosovës, veç po dua me ju thënë se kërkesa e juaj Ardita është qesharake.

**znj. Ardita Rrahmani:** Jo, nuk jam për me marrë vëmendjen. Qysh po thoni se kërkesa për ndërtimin e shkollës është qesharake?

**znj. Ernesta Krasniqi:** Jo kërkesa për ndërtimin e shkollës, por kërkesa për me ndarë në kod të veçantë, është qesharake, sepse, projekti është në procedurë të prokurimit. Kontrata ose është nënshkruar, ose është në procedurë të nënshkrimit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Meqë pati përzierje të diskutimeve, duke marrë fjalën njëkohësisht Ernesta dhe Ardita, atëherë kryesuesi kërkoj me i ndalë mikrofonat.

**znj. Ardita Rrahmani:** Nëse është ashtu, atëherë Ernesta duhet t'i informoni qytetarët se janë ndarë 6 milion euro për ndërtimin e shkollës. Pse nuk e keni dhënë këtë informatë?

**znj. Hafize Sallahi:** Desha të sqaroj vetëm diçka, se e kam pasur si obligim në pozitën e drejtoreshës. Me erdhi keq që u përdorën këtu edhe varrezat e dëshmorëve. Për hir të qytetarëve, ju njoftoj se unë e kam pasur projektin për menaxhim të kompleksit të varrezave të dëshmorëve, DSHPE ka pasur mirëmbajtjen e kompleksit. Mund të themi me sinqeritetin me të madh, se për 4 vite, nuk kemi pasur asnjë ankesë për mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve. Të çështja e flamujve, kam qenë menaxhere e vendosjes së flamujve. Ernesta, ndodhë që kur ka erëra e shi, të shqyhen flamujt, por asnjëherë nuk ka ndodhë 3-4 javë me qëndruar flamujt në vendet kyçe ashtu, kemi bërë stolisjen e qytetit për festa të ndryshme. Për hir të qytetarëve, unë ju informoj se nuk kemi pasur asnjëherë ankesa të qytetarëve, dhe është një nder komplekset që po zhvillohet për së mbari. Në vend që sot të thuhet që kompleksi i varrezave të dëshmorëve ka marrë pamje të re, është njëri nder komplekset me pamje me të mirë në nivel vendi, që kemi marrë shumë merita edhe nga komunat tjera. sot është turp me dëgjuar familjet e dëshmorëve për çështjen e mirëmbajtjes së varrezave, kur dihet se është një punëtor aty i punësuar.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Çështjen e mirëmbajtjes së varrezave të dëshmorëve, ne të gjithë jemi me pa atë vend sa me mirë dhe sa me të mirëmbajtur. Atë që e tha Ernesta, për festën e 17 shkurtit, ish drejtoreshë- tani kolege asambeiste, pllakat e varrezave kanë qenë me baltë, jo të mirëmbajtura. Ne marrim ankesa nga familjet e dëshmorëve, nuk është në rregull një grua e dëshmorit me vizitua varrin e bashkëshortit, duke zënë nëpër kubëza. Kam foto, ku shihet një tubë e kubzave të mbledhura në një kënd, është mirë së paku në festat zyrtare, me qenë të mirëmbajtura varrezat e dëshmorëve.

**znj. Hafize Sallahi:** Nëse ka qenë fjala për këtë 17 shkurt, unë mendova se je duke folur në përgjithësi për mirëmbajtje të varrezave të dëshmorëve, kërkoj falje se është një projekt aty i papërfunduar. Kubëzat janë të dëmtuara, shpresoj shumë me projektin e radhës kanë me u rregulluar edhe rrugicat që janë të parapara në projekt në 4 vjetshin e ardhshëm. Kryetari na plotëson me shumë, se aty ku e kam lënë unë, besoj se ka me vazhduar ai projekt.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kërkoj të mos dilni jashtë rendit të punës.

**z. Jeton Luma:** Të Raporti i ekzekutivi, të pika 3 të Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, shkruan: “Komuna e Kaçanikut është njëra ndër komunat me potencial të lartë për zhvillimin e turizmit në Kosovë, veçanërisht turizmi malor. Duke u bazuar në këtë potencial, gjatë këtij viti jemi angazhuar në promovimin e tij përmes bashkëpunimit dhe realizimit të projekteve konkrete, me synim, nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe promovimin e vlerave historike, kulturore dhe natyrore të vendit tonë”. Komuna e Kaçanikut ka një potencial të jashtëzakonshëm siç është bujqësia, blegtoria, turizmi malorë. Ju keni investuar në f. Strazhë, i kam pa investimet në atë fshat si pika me strategjike për zhvillimin e turizmit, por, nëse e shikon si objektivi, duke munduar me rregulluar, e dëmton me tepër natyrën. Duke ditur se komuna ka një potencial për zhvillimin e turizmit, unë nuk e shoh askund se është promovuar turizmi, e sidomos në f. Strazhë. E dyta, dëmtimi i pyjeve. Faji shihet se i është hedhur institucioneve tjera. Nëse shkon rrugës së Sharrit, Doganaj-Gllloboçicë, e shihni në çfarë krahure në atë rrugë. Pyjet që janë prerë, janë dëmtuar, komuna duhet me pasur një rol këtu, me pasur një plan. Thuhet se pyjet i përkasin rajonit të Prizrenit. Si komunë duhet të mbrojmë pyjet tona, jo me i lënë me u dëmtuar në atë masë. Të investimet në infrastrukturën shkollore të DA, thuhet: “DKA edhe gjatë vitit që lamë pas, është angazhuar për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe krijimin e kushteve sa me të mira për zhvillimin e procesit mësimor dhe ngritjen e cilësisë në arsim” Kjo është hyrja e shkollës “Gafurr Luma” në Gllloboçicë, shikoni në foto çatinë e cila mbahet nga druri, ndërkaq fëmijët, nxënësit kalojnë atypari kah ky dru.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk jeni ju ekspert me i vlerësuar ato gjëra.

**z. Jeton Luma:** Sa kohë ka qëndruar ajo dërrasë aty. Nëse janë vendosur shufra metalik, a e dini që nuk ka siguri për fëmijët e shkollës.

**z. Gazmend Bunjaku:** Po përgjigjem në tre pyetje që u ngritën 1. Për pyetjen e Jetonit, nuk e s'di se kur është bërë ajo foto. Unë para dy ditëve kam qenë në vizitë të asaj shkolle, nuk ka qenë ajo gjendje. Aty është një shtyllë elektrike e lakuar, jashtë oborrit, e cila paraqet rrezik. Ju si anëtar i KK, a e keni ngritur këtë çështje me paraqitur si rrezik? Para disa ditëve nga erërat është dëmtuar çatia e llamarinës. E kam vizituar shkollën dhe kam nisur procedurat për rregullimin e saj. Të bursat, kanë përfituar në vitin e kaluar 46 bursist, në shumën 23 mijë euro.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Për atë kryesues duhet me qenë replika. Kur të bëjmë pyetje, me marrë përgjigjen e saktë, se ka qytetarë që na kanë thënë me i ngritur këto çështje. Me këtë përgjigje që e tha drejtori, po bien në kundërshtim me kryetarin që theksoj se janë ndarë 50 bursa. Pse po manipuloni?

**Kryetari i Komunës:** Nuk jemi duke manipuluar. Unë kam me të treguar pse janë shpërndarë 45 bursa, pse i kemi hequr 5 bursistë.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Me more mua fjalën nuk me krijove mundësinë me bërë replikë. Pse me u përgjigjur bashkëbiseduesi tjetër, unë me herët e kam bërë pyetjen. Kryesues, mbani rendin siç duhet. Dua me sqaruar çështjen e bursave, është një rast shumë i ndjeshëm. Unë nga ky moment i thërras edhe mediat e sidomos Kallzo.com, me ardhur me hulumtuar dhe unë jam në gjendje me ndihmuar, me dal në pah qysh po manipuloni. Keni qenë pjesë e ekzekutivit dhe thoni se janë ndarë 50 bursa, ndërkaq janë ndarë 45 bursa. Pse mungon çështja e bursave në raport të ekzekutivit dhe në atë financiar? Çështja e bursave është shumë serioze për administrimin e bursave në komunën e Kaçanikut dhe për transparencën e këtij procesi. Po e bëjë një kronologji zyrtare të çështjes së bursave: Me 30.01.2025 është hapur konkursi për bursa deri me 19.02.2025. Konkursi për bursa universitar, 03.03.2025. Rezultatet e bursave universitarë janë publikuar me 02.05.2025, komuna i ka publikuar me

13.05.2025. Pas publikimi, studentët janë njoftuar me i sjellë dokumentet e nevojshme, kopjen e letërnjoftimit, gjiro llogarinë. Është dalë njoftimi se përfitues janë 50 studentë. Në momentin që kanë dal emrat, janë kontaktuar studentët, me i sjellë të dhënat për subvencionim. Nga 50 studentë përfitues të bursave, janë larguar 5 studentë. Komuna nuk ka gjetur metoda me i subvencionuar studentët e dalluar, por i ndëshkon dhe manipulon, e publikon listën dhe nuk ua jep mjetet. Ky arsytim është i pakuptimtë dhe bien ndeshë me logjikën dhe praktikën e bursave në shumicën e komunave. Komuna i njofton studentë se janë përfitues të bursës, i thërret me sjellë dokumente dhe pas dorëzimit të dokumenteve i përjashton nga lista. Studentët janë njoftuar me email për përfitim të bursës, por kjo nuk përputhet me atë që ka publikuar komuna. Në letër ata studentë janë përfitues të bursës, ndërkaq në realitet nuk i kanë marrë mjetet. Ankesat që i kanë bërë DA apo ekzekutivi, nuk iu kanë kthyer përgjigje në afatin e caktuar. Këta ju kanë referuar një rregulloreje që ata që janë përfitues të bursës universitare, nuk mund të jenë edhe përfitues të bursës së komunës. Pse nuk është bërë e ditur zyrtarisht se këta 5 bursistë hiqen nga lista? Këtu fshehët një sekret, se nuk dihet ku shkojnë ato mjete. Pyetja, qysh mendoni kryetar me motivuar studentët që po thoni po e rriti numrin e bursistëve nga 50-60, pse nuk e thoni nga 45 në 55 bursistë? Ju kryetar me thatë se kanë qenë përfitues 50 studentë, po manipuloni me shtresën me të ndjeshme -studentët. Qysh keni me u ndier ju studentë të nderuar, kur kryetari thotë se kanë përfituar bursë 50 studentë, e që përfitues kanë qenë 45 studentë. Ju jeni ndëshkuar nga po ky kryetar. Pse nuk janë kthyer përgjigjet në ankesa studentëve, janë 4 vajza të zonja që kanë qenë përfituese, ky kryetar ka qenë pjesë e ekzekutivit në mandatin e kaluar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Duhesh me pasur respekt, në gjuhën që po përdorni. Bëni pyetjen, e mërr përgjigjen, se je duke i përsëritur disa herë të njëjtat fjalë. Siç duket, ju po doni me iu dëgjuar vetëm juve kur diskutoni.

**znj.Kadrije Lika Troni:** Krejt familjet kanë studentë. Qysh kryetar me fshehur numrin e përfituesve të bursave?

**Kryetari i Komunës:** E para kryesues, mendoj se duhet me qenë pak me të përpiktë në menaxhimin e seancës, për arsye nëse kërkohet me u dhënë përgjigje direk, iu përgjigjem. mos të lëmë hapësirë për ndërhyrje. Unë po kam durimin me dëgjuar edhe fjalë fyese nga anëtarët e KK, por ajo të mbetet në ndërgjegjen e gjithsecilit. Të çështja e bursave, hynë në faqen e komunës, e shihni që konkursi është shpallë për 50 bursa. Të vërejtja (fokusuar nga kamera) e keni të potencuar se ata që kanë bursë universitare nuk mund të jenë përfitues të bursës komunale. Ministria i ka vonuar rezultatet, ka qenë procedurë, kur e kemi vërtetuar përfituesit, janë hequr ata që kanë përfituar bursë universitare, nuk është dashur ndoshta këtu me aplikuar. Nëse thoni që po manipuloj me qytetarët, me studentët, është fjalë goxha e rëndë. Janë të argumentuara, shpallja për bursa ka qenë për 50 veta, është në vërejtje që ata që janë përfitues të bursës universitare, nuk mund të jenë përfitues të bursës komunale, edhe pse janë të pamjaftueshme me i marrë dyja, por ata 5 studentë, ne i kalkulojmë me marrë 5 studentë tjerë. Nëse ti nuk mundesh me u pajtua me kryetarin aktual, apo siç po thoni kryetari në ardhje, ajo është çështje e juaja.

**znj.Kadrije Lika Troni:** Me është përmendur emri, duhet me marrë fjalën. Emrat e studentëve janë keqpërdorur.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E keni bërë pyetjen, të kthehet përgjigja. Përgjigja të kthehet qysh është, jo qysh po doni ju. Ju jeni duke prishur rendin e mbledhjes.

**znj.Kadrije Lika Troni:** Ju nuk jeni duke mbajtur rendin si duhet, unë qysh në fillim desha me replikuar, se ku po mbesin përgjigjet atëherë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne e kemi bërë një rend, i cili ka qenë edhe me herët. Janë marrë pyetjet, janë përshkuar nga kryetari dhe drejtorët, janë dhënë përgjigjet emër për emër. Unë

mendoj se nëse ju e ngitni një pyetje, përgjigjet kryetari, ju kërkoni repikë, atëherë po prishet rendi. Se nëse bëhen pyetje- përgjigje, kjo i bien bashkëbisedim. Kështu që merren pyetjet e secilit, epen përgjigjet. Kryetari të dha përgjigjen, a ju pëlqen juve apo jo, është çështje tjetër.

**z. Brahim Imishti:** Nunë nuk e di pse po mundoheni me demanizua suksesin dhe angazhimin e ekzekutivit, kur çdo gjë është konkrete, shihet, preket dhe me imagjinuar. Investimet e komunës i ka vlerësuar qytetari, pikërisht këtë raport të dokumentuar dhe protokolluar e ka vlerësuar qytetari. Unë e di se juve, humbja në zgjedhje ka qenë e dhimbshme, iu ka lënë edhe plagë, kështu që sukcesi dhe angazhimi i ekzekutivit për ju është "acid klorhidrik". Me vjen keq që nuk e vlerësoni punën dhe angazhimin e komunës.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Fjalën manipulim ju e sjellët në KK. Është tejet e ndjeshëm diskutimi që e bëri kolegja për çështjen e bursave, se ata studente ende mendojnë se kanë përfitur bursën, por nuk janë përfitues, dhe nuk po e kuptojnë përgjigjet se ku kanë shkuar këto mjete. Nëse është dikush që po manipulon me qytetarë, jeni pikërisht ju kryetar. Nuk ka nevojë me shkuar të rrethi për gjendjen e flamurit, por shikoje këtu. Manipuloni për bursa, për çështje të ndjeshme. Për derisa kryetari nuk ka respekt për ne, njëjtë edhe ne veprojmë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk është në rregull mos me treguar respekt. Juve iu shkon për shtati mos respekti.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kërkoj përgjigje nga drejtori për rrugët e shtruara të cilat nuk janë të definuar, se kryetari nuk dha ndonjë përgjigje. Dua me ditur se cilat rrugë janë shtruar, sa ka kushtuar metri i rrugëve të shtruara, zhavorrit, se unë dua me kalkuluar planifikimin me realizimin.

**z. Valdrin Dogani:** Të bursat, del shpallja, aplikojnë studentët, formohet komisioni që i verifikon dokumentet, e jap një rekomandim për kryetarin për me i subvencionuar studentet. Në listë kanë qenë 50 përfitues, kur ka dal rezultati i atyre universitare është vërejtur se ka përfitues të bursave universitare. Ne e kemi si vërejtje, se nuk lejon me marrë bursë komunale ai studentë që përfiton bursën universitare. Me vendim të kryetarit janë financiar 46 studentë, nga 500€, në total, 23 mijë euro, pjesa e parë ka qenë 11 mijë e 500€ që është dhënë në fund të muajit të katërt, pjesa tjetër është dhënë para përfundimit të vitit akademik. Specifikimi i bursave ka qenë edhe në raportet financiare, mund ti keni harruar. Për rrugët, janë kontrata në prokurim, ne si drejtori i kryejmë vetëm pagesat. Projektet janë në DUKMM, por nuk e di tani drejtori a ka ndonjë informatë, ose ua përcjelli me shkrim, se drejtori është i ri në këtë pozitë.

**z. Jeton Luma:** I mbeta borgj drejtori të DA. E para, dërrasa e vendosur aty të shkolla. a e dini sa kohë ka qëndruar aty? E dyta, duke qenë një masë betoni që llogaritet të kenë shumë peshë, a mendoni që janë të mjaftueshme dy shufrat metalike për me i siguruar nxënësit? Unë kam qenë i pari që kam paraqitur rastin e shtyllës elektrike që është e dëmtuar, mundem me të dëshmuar në mbledhjen vijuese. A keni vizituar tualetet në shkollën e Gllloboçicës. me pa gjendjen e tyre?

**z. Gazmend Bunjaku:** Po, e kam vizituar krejt objektin e shkollës në Gllloboçicë, i kam vizituar të gjitha klasat, e kam marrë edhe kërkesën prej drejtorit për investimet që duhet me i bërë aty. Ju e dini që shkolla dhe arsimit janë institucion shumë komplekse, kërkohet angazhim i të gjithëve për me rregulluar gjendjen. Ne si komunë e dini se nuk mund të dalim nga obligimet e kontratës kolektive sipas vendimeve të gjykatave, pa fajin tonë, dhe e kemi të pamundur me ndërhyrë në investime të objekteve shkollore. Këtu po ndërldhem edhe me Buletinin, i cili ka qenë pjesë e aktivitetit vullnetar në lyerjen e shkollës Nikaj, bashkë me disa kolegë, profesor, drejtor shkolle, zyrtar të DA që kanë marrë iniciativë për me përmirësuar gjendjen e shkollës. Ka qenë e padrejtë mos me përmendur në informatë

këtë vullnetarizëm- gjest human, vullnetarizmi dhe bujaria, nuk ka ligj në botë që e ndalon. Përkundrazi, unë inkurajoj edhe Buletinin edhe Jetonin, kur kanë këso iniciativa, po foli edhe në emër të kryetarit dhe ekzekutivit, kemi me iu bashkangjitur, kur janë në favor të krijimit të kushteve për fëmijët, nxënësit, arsimtarët, shkollat dhe për gjithë neve.

**z. Buletin Guri:** Unë Gazmend, sa herë ka iniciativa të tilla marrë pjesë, por përderisa ndahen 30 mijë euro për shkollat tjera, ndërkaq për shkollën e Nikaj nuk ndahen mjete. atëherë, jeni i obliguar në mënyrë automatike me dalë në mënyrë vullnetare e me bërë diçka në të mirë të komunitetit. Edhe ju sa herë që nuk veproni sikurse në shkollat tjera, unë prapë kam me vepruar njëjtë.

**znj.Kadrije Lika Troni:** Pyetje për drejtorin, A janë ndarë 45 apo 46 bursa për studentë. Në bazë të hulumtimeve që i kam bërë janë 45 studentë, 5 studentëve iu ka shkuar njoftimi se janë largua nga lista. Si doli edhe përfituesi i 46 i bursave?

**z. Valdrin Dogani:** Të siguroj listën prej 46 bursistëve. Arsyeja 45 janë dërguar në thesar dhe janë ekzekutuar sikurse ekzekutohen pagat. Për 1 përfitues që i ka sjellë dokumentet me vonesë, i kemi zotuar mjetet ne dhe e kemi paguar. Mundem me ti përcjellë emrat dhe mbiemrat.

**znj.Kadrije Lika Troni:** Drejtor, ku është transparenca në këtë rast, e keni shtuar një bursist, qytetarët nuk janë të njoftuar.

**z. Valdrin Dogani:** Jeni duke keqkuptuar, se nuk e kemi shtuar askënd, 50 ka qenë lista e përfitueseve, iu ka rekomanduar kryetari, 4 janë hequr, ta dëshmojë. Të bursisti i fundit, kemi kërkuar llogarinë bankare se e ka gabuar banka. E ka sjellë, dhe i kemi zotuar mjetet dhe ia kemi proceduar. Shumë procedurë e thjeshtë dhe ligjore, kam me të përcjellë listën e përfituesve përmes emailit.

**znj.Kadrije Lika Troni:** Me përcjellë edhe listën e 4 përfituesve që janë hequr nga lista.

**z. Valdrin Dogani:** Ka qenë rekomandim i komisionit për 50 bursistë, janë tërhequr 4 se nuk kanë të drejtë me i përfituar dy bursa.

**znj.Kadrije Lika Troni:** Studentët që janë tërhequr, pse nuk janë zëvendësuar me ata që kanë qenë në radhë të listës dhe me u editua ajo listë dhe me dalë me 50 përfitues. aq sa janë ndarë mjetet? Pse është shtuar 1 bursist, kjo po me intereson mua se qytetarët nuk e dinë që është shtuar një bursist e janë bërë 46? Qytetarët nuk e dinë që kanë përfituar 45 bursist. Kjo është e dhimbshme, është prekur dinjiteti i studentit, kjo krijon një pakënaqësi të studentit, ka përfituar bursën, është në faqe të parë të listës dhe hiqet, në vend që nga komuna me iu dhënë shtytje, ata degradohen.

**z. Valdrin Dogani:** Komuna ka studentë të dalluar, besoj secili e ka pa vërejtjen, ku shënohet se aplikuesi nuk mund të jetë përfitues, nëse është përfitues i bursës nga niveli qendror ose të ndonjë donatori të fushës së njëjtë.

**znj.Kadrije Lika Troni:** Në komunën e Kaçanikut është hapur konkursi para se me u hapur nga niveli qendror. Kur e keni pritur rezultatin e nivelit qendror, pse e keni hapur konkursin me herët.

**z. Valdrin Dogani:** Rekomandimi nuk është vendim, por është shkresë që i drejtohet kryetarit për me ndarë bursa.

**znj. Hafize Sallahi:** Të çështja e bursave, ne kemi studentë të dalluar të komunës tonë, njëri është djali i vëllait tim, i cili është shpërblyer me mirënjohje në komunën e Kaçanikut, studentit me i miri në UP, që është për të përgëzuar, ka qenë edhe përmes mediave, por nuk është përfitues i bursës, për shkak se është përfitues i bursës universitare. Ne si kuvendar duhet me kërkuar me hequr atë kriter në rregulloren e komunës, mundemi në mbledhjen vijuese dhe të përfitojnë nga dy bursa, se edhe unë dhe çdo qytetar nuk është i pajtimt që studentit me nota 10-tëshe me mbetur pa bursë të komunës. Rregulloren e kemi bërë vet, si çdo komunë tjetër që kanë rregullore të njëjtë. Duke pasur parasysh buxhetin, për kohën

ndoshta ka qenë e arsyeshme, ndërkaq rregullorja mund të ndryshohet për të ardhmen, e mos me humbur kohë me debatuar.

**znj. Ardita Rrahmani:** Pasi kanë interesim, është mirë me kërkuar për mbledhjen vijuese me u ndryshuar rregullorja, njëjtë qysh kam kërkuar unë në legjislaturën e kaluar, por nuk ka kaluar. Në rregullore thuhet se nuk mund të jenë përfitues 2 kandidatë prej një familje. Unë kam kërkuar me u hequr ky kriter, por nuk ka kaluar. Për mos me u stërzgatur kjo çështje, është mirë është me rishqyrtuar, ashtu qysh thotë ligji, rregullorja.

**z.Buletin Guri:** Për drejtorin e arsimit, Përpos iniciativës për renovimin e shkollës Nikaj, banorët e f. Nikaj vazhdimisht e bëjnë edhe pastrimin e varrezave dhe trotuareve, për shkak të neglizhencës së institucioneve komunale. Unë para vetës e kam një kontratë që ka qenë aktive deri në janar 2026, ku thotë se mirëmbajtja e rrugëve verore dhe dimërore, pika 1.2., pastrimi i trotuareve dhe shtigjeve të këmbësoreve me largim të materialit deri në deponi. Imagjinoni, komuna e ka pasur deri tani një kontratë që paguan pastrimin e trotuarit me një çmim qesharak, 0.10 cent. Nëse komuna e Kaçanikut i ka 100 km trotuar, ajo kompani duhet me i pastruar me profit 10€. Kjo normal është e perealizueshme, dhe banorët detyrohen me i kryer këto punë që janë në përgjegjësi të institucioneve komunale.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sa i përket punës vullnetare në shkolla Buletin, ne krejt kemi ndihmuar. Unë edhe vet kam ndihmuar, por nuk e kemi bërë publik se e kemi dhënë një kontribut. Kontribut shoqëror, jo vetëm unë, por ka shumë aty që kanë kontribuar në shkolla.

**z.Buletin Guri:** E pagëzoi vullnetarizmin e juaj dhe të secilit qytetarë të komunës, por nëse komuna intervenon me kohë në renovimin e shkollave, pastron trotuare, nuk ka nevojë qytetarët me dalë me rinovuar shkolla e pastruar trotuare, për derisa ka kontrata aktive. Ndahen mjete 30 mijë euro për renovim të 3 shkollave, f. Nikaj detyrohet me punë vullnetare, ndërkaq komuna ka kontratë aktive për renovim të shkollave. Është 10 cent kontrata e mirëmbajtjes së trotuareve, ndërkaq qytetarët detyrohen me pastruar vet trotuaret, se janë të pakalueshme. Atëherë nëse vazhdoni me pasur këso kontrata aktive me 10 cent, kur të investoni në trotuare, investoni si duhet, që të paktën të jenë të vet mirëmbajtura, shtroni me asfalt trotuaret.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Faleminderit shumë për idenë.

**z. Hestet Malsiu:** Krejt rrugët e shtruara me 3m gjerësi, u arsyetuan me shtrimin e një rruge të shtëpia e doktor Lulit. Edhe njëherë po ju kthehem shifrave, prej 5077metra janë me 3m gjerësi, vetëm 965 metra rrugë gjatësi janë me 4m gjerësi. Kjo i bien se mbi 90% e rrugëve me 3m gjerësi. Nëse i mbledhim krejt rrugët e shtruara, del se janë 5135 metra, nga shifra e përgjithshme, apo përgjysmë me pak.

**znj.Kadrije Lika Troni:** Nuk e kam marrë përgjigjen të shkallëve të guri i shpumë.

**Kryetari i Komunës:** Shkallët kanë garancion 1 vit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, kjo kalon si Informatë, se raporti i ekzekutivit nuk votohet. Konstatohet se Kuvendi i Komunës

#### **NJOFTOHET**

**Me Raportin e punës i Ekzekutivit të komunës për vitin 2025/Lënda: 01Nr.104/02-4152/26.**

**3. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Islam Gashi:** Raportin që e kemi para vetës, nuk duhet të shikohet vetëm në aspektin e realizimit, por edhe të planifikimit dhe diferencave. Unë do të ndalem kryesisht të disa dallime, pika 1. është dallimi në mes të buxhetit fillestar dhe final. Buxheti fillestar është 122.59 milion euro, ndërkaq buxheti final 14.30 milion euro, kemi rritje prej 1.7 milion euro. Një pjesë e ngritjes vjen nga kategoria e pagave, për shkak të ndryshimit të koeficientit, me shqetësuese është se pjesa tjetër e mjeteve ka ardhur nga mjetet e bartura nga kategoria e të HVK, të pashpenzuara nga viti 2024, mbi 1 milion euro. Këtu janë dy çështje, ose ka qenë planifikimi i dobët, ose te të HVK janë bartur me qëllim nga vitet paraprake për me u bartur në vitin 2025, për shkak se ka qenë vit zgjedhor. Kjo e dëshmon se në dy vitet e kaluara kanë rreth 1 milion euro që janë bartur, në vitin e fundit kanë rënë ndjeshëm. Ka mosrealizim të shpenzimeve kapitale, buxheti fillestar për IK ka qenë 3.4 milion euro, ndërsa ai final në 4.5 milion euro me një rritje mbi 1 milion euro., ndërkaq kanë ngelur 277 mijë euro të pashpenzuara. Në bazë të mjeteve të bartura, mund të konkludojmë se komuna nuk ka problem me mjete, por ka problem me projekte. Shqetësuese është inkasimi i të HVK, në vitin 2025 të hyrat tatimore kanë qenë 270 mijë euro, ndërkaq buxheti i planifikuar 430 mijë euro, mosrealizim 160 mijë euro. A ka gjetur komuna mekanizëm për realizimin e këtyre të hyrave. Kam një pyetje për drejtorin e financave apo kryetarin, sa është vlera totale e tatimit në pronë që komuna nuk arrin të arkëtoj. Shqetësuese është vlera e lartë e detyrimeve kontingjente, edhe pse këto detyrime janë obligime të mundshme që ndodhin sipas vendimeve të gjykatave, mirëpo kjo vlerë aq e lartë. janë obligim i buxhetit të komunës. Kërkoj një sqarim për pagesat sipas vendimeve gjyqësore, janë mbi 1 milion euro prej IK, A janë pagesa ndaj operatorëve ekonomik, nëse po, sa është pagesa për vonesa. Të kategoria e mallrave dhe shërbimeve, 190 mijë euro, për vendime gjyqësore, çka përfshinë këto shpenzime.

**z. Valdrin Dogani:** Vendimet gjyqësore të gjithë e dimë se na kanë shkaktuar sfida edhe në planifikim edhe në realizim buxheti, sidomos në vitin e fundit, ku janë mbi 1 milion e 300 mijë euro pagesa për to. Ndodhë që departamenti i thesarit na tërheqin mjetet dhe në dërgojnë një specifikacion se për cilat lëndë i kanë marrë mjetet. Shumica e mjeteve apo 95% janë për kontratat kolektive në arsim. Ne për me iu shmangur gjobave, përmbaruesit, në vitin e fundit e kemi përdorur një praktikë, paditësi ka kërkuar një vlerë me tepër sesa duhet, ne kemi arritur njëfarë pajtimi gjyqësor me palën, ia kemi llogaritur në total, orët, km. përmes një komisioni dhe e kemi kompensuar, vetëm me shmangë atë vendimin përmbarimor, se dihet se ka kosto me të lartë. Të tatimet në pronë, është e vërtetë se ka borgje, mjete të pa arkëtuara, neni 16, raport për të pa arkëtuarat të tatimi në pronë, 2 milioion e 263 mijë pa inkasuara. Faktorët, janë heqja e kushtëzimit për regjistrim të automjeteve, nga viti 2016 kam punuar në atë sektor, e di që shumica e qytetarëve kur ka ardhur me regjistruar automjetin nuk iu ka lëshuar vërtetimi pa pagesën e tatimit në pronë dhe e ka paguar tatimin. Faktor tjetër, me ligjin e ligjin e ri të tatimit në pronë i vitit të kaluar, është rritja për zbritje e vendbanimit parësor. Tatimi në pronë caktohet në bazë të vlerës së objekti, ku del totali për pagesë. Me herët ka qenë zbritja për objektin parësor 15 mijë euro, tani është 30 mijë euro., ku shumë objekte nuk taten fare. Tjetër, është falja e tatimit në pronë nga qeveria e Kosovës, që ka krijuar hamendje. Ne nuk e kemi falur, se nuk kemi buxhet të mjaftueshëm me falë atë obligim, të arkëtuarat kjo veç shkon duke u rritur.

**z. Islam Gashi:** Meqë janë mbi 2 milion uro të pa arkëtuara, a ka marrë komuna mekanizëm për arkëtimin e këtyre të hyrave. Nuk besoj se është shqetësim shumë ajo që e potencove, ndryshimi i normave tatimore. Ju e dhatë informatën që është ngritur tatimi në pronë, ndërkaq realisht po i bien se është zvogëluar.

**z. Valdrin Dogani:** Unë po e themi atë në ligj që është e potencuar.

**Nënkryetari i Komunës-Xhelal Dema:** Gjatë vitit 2024 kanë pasur me hyrë në fuqi pronat për njësi, dhe është janë aprovuar këtu në KK normat për pronat komunale, çmimet për m2 i

cakton ministria. Kuvendi i Komunës pasi ka marrë vendim për normat tatimore, na ka ardhur nga niveli qendror me u anuluar ai vendim. Kur është anuluar vendimi, kemi shkuar në minimum të normave tatimore, kështu që nuk kemi pasur mundësi me pasur ngritje të tyre. Përveç asaj, zbritja për objektin parësor, 30 mijë euro për shtëpi dhe 50 mijë euro për parcelën me të madhe të tokës, i ka hequr nga tatimi diku 4 mijë shtëpi, kështu nuk ka mundur me qenë inkasimi me i madh.

**z. Islam Gashi:** Ajo nuk e amnistoni pjesën që nuk është inkasuar. Ka borje të vitit 2025, ka edhe borje të viteve tjera.

**Nënkryetari i Komunës:** Nuk janë duke amnistuar, ato janë norma tatimore.

**z. Valdrin Dogani:** Islami pyeti a keni marrë diçka në këtë drejtim. Në planin e punës së ekzekutivit të vitit 2026, të sektori i tatimit në pronës, është paraparë një fushatë vetëdijësuese, që me ndërlidhur pagesën e tatimit në pronë me investime kapitale.

**Nënkryetari i Komunës:** Ne kemi vepruar edhe me përmbarues të borjëlinjtë me të mëdhenj, kam pritur me shumë realizim, por nuk ka dalë qysh kemi menduar, jo me fajin tonë

**z. Bashkim Krasniqi:** Para vetës e kemi një raport financiar të vitit 2025. Mendoj se si raport është shumë i mirë, i detajuar, korrekt. Duhet theksuar se të hyrat nga GQ janë shpenzuar 99.9%, që është sukses, këtë nuk mundemi me tejkaluar. Të HVK barten vit pas viti, se të HVK inkasohen edhe në pjesën e dytë të vitit. Prioritet për ekzekutivin është çdo me shpenzuar GQ, sepse nëse nuk shpenzohen, kthehen në deficit buxhetor. Të HVK edhe nëse nuk shpenzohen, barten në vitin tjetër, mendoj që është sukses i ekzekutivit që ka arritur me shpenzuar GQ 99.9%.

**z. Islam Gashi:** Vonesa në bartjen e mjeteve vetanake, realisht e vonon realizimin e projektit. Për atë është mirë me shfrytëzuar qytetarët projektin në atë vit sesa me u shtyrë për vit tjetër. Kur jemi të GQ, diku rreth 50% shkojnë për paga, kjo nuk e matë performancën.

**z. Valdrin Dogani:** Islami, edhe 50% e mjeteve tjera nga GQ nuk janë pak dhe e matë performancën e komunës.

**z. Islam Gashi:** Nuk mundeni me thënë se kemi qenë shumë të mirë në performancën komunale në realizimin e GQ.

**z. Valdrin Dogani:** Realizimi i buxhetit është një prej matësve të performancës komunale. Si kusht për performancë, është shpenzimi i buxhetit, sidomos të investimet kapitale. Nuk po themi se kemi qenë shumë të mirë, ne vetëm i tregojmë shifrat reale.

**z. Bashkim Krasniqi:** Po ndërlidhem me kolegun që thotë se nuk keni qenë shumë të mirë. Nëse GQ shpenzohet 99.9%, çka po mendoni ju me qenë me mirë. Tjetra, të HVK e di se ju bëni presion me i shpenzuar të HVK duke shkelur ligjin, këtu nuk shkelet ligji, se nuk mundeni me u shpenzuar të HVK të cilat inkasohen në muajin e 12, ju i dini kohën e tenderimit, i dini rregulloret e ligjet. Pse po mundoheni me krijuar përshtypje se këta nuk po dinë me punuar? Ju po mundoheni edhe suksesin me paraqitur si dështim, kjo nuk iu shkon, mos flisni gjëra të kota.

**z. Islam Gashi:** Nëse mendoni ju që janë gjëra të kota, a mendoni ju që 400 mijë euro janë të muajit dhjetor të cilat janë bartur?

**z. Bashkim Krasniqi:** Sesa kanë hyrë në vitin e dytë, janë shpenzuar 1 milion e 640 mijë euro, me shumë sesa ka pasur të hyra në këtë vit. Të bartura nga viti 2024, janë 1 milion e 33 mijë euro. Janë shpenzuar 1 milion e 600 mijë euro me shumë sesa ka pasur të hyra.

**z. Valdrin Dogani:** Sa për sqarim të HVK, fillimisht është planifikimi, pastaj bëhet inkasimi me i realizuar këto mjete. Ne i kemi dërguar mjetet në muajin korrik, afër 80 mijë euro, i kemi dërguar me rialokuar nëpër këto projekte. Departamenti i thesarit nuk na i ka

alokuar, për shkak të vendimeve gjyqësore që i kemi. Në momentin që i kemi alokuar, ne sa herë i kemi tërhequr mjetet. E përmenda edhe me herët që kemi pasur shumë borgje të kontratës kolektive në arsim.

**z. Islam Gashi:** Është interesant qysh çdo vjet nuk keni arritur ato të HVK me i realizuar në projekte, ndërkaq në vitin 2025, i cili ishte vit zgjedhor, mjetet e viteve të kaluara, i keni bartur dhe realizuar.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Pyetje për drejtorin për mjetet për mallra e shërbime, Mirëmbajtja e rrugëve lokale në vitin 2025 ka qenë 366 mijë euro, në vitin 2024, 252 mijë euro. Sa ka qenë kontrata e mirëmbajtjes së rrugëve?

**z. Valdrin Dogani:** Mirëmbajtja e ndriçimit publik është 32 mijë euro. Nuk i mbajë mend të gjitha, janë kontratat në Zyrën e prokurimit. Dua të sqaroj se secilën rrugë që e shtrajmë, apo ndriçim publik, secila kërkon mirëmbajtje, kuptohet se rritja e shumës bëhet me arsye.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Mendoj se është kot, për këtë arsye siç e potencova. Mirëmbajtja e rrugëve lokale në vitin 2025 ka qenë 366 mijë euro, në vitin 2024, 252 mijë euro. Nëse i kalkulojmë këto shifra, i bien diku 618 mijë euro. Kontrata e cila ju e keni nënshkruar në fillim të vitin 2024 dy vjeçare, ka qenë 475 mijë euro. Sa keni të drejtë me shpenzuar mjete mbi këtë vlerë të kontratës?

**z. Valdrin Dogani:** Unë e di se kemi të drejtë vetëm 10% me shpenzuar mbi kontratën, por ato pagesa nuk janë bërë për atë operator që po mendoni ju, janë bërë për 3 kontrata aktive, jo veç për mirëmbajtjen e rrugëve.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kjo është keqpërdorim, nuk e di drejtori i mallrave dhe shërbimeve a është këtu.

**z. Valdrin Dogani:** Drejtor të mallrave dhe shërbimeve nuk ka. I ka drejtori kontratat aktive në DSHPE me situacion.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Me falni. 143 mijë euro janë shpenzuar drejtor mbi kontratën. Ju që nuk dilni jashtë ligjit, vetëm një po e potencoj, është turp vetëm 10 cent metra me i pastruar trotuaret. 100 km. Trotuar me i pasur Kaçaniku, i kryen çdo muaj me 10 euro, ndërkaq janë bërë 2 vjet dhe nuk i keni mirëmbajtur të paktën njëherë këto trotuare. Faji i juaj, keqpërdorimi i buxhetit, qytetarët, fëmijët, nxënësit, detyrohen me ecur në mes të rrugës, se nuk iu ka ra ndërmend me i bërë presion operatorit ekonomik me i pastruar trotuaret. A e dini gjendjen e rrugës të "Emsale Frangu" të Skënderbeu, të shkollë "Qamil Ilazi" rruga Komandant Bardhi, nxënësit nuk kanë nga të ecin në trotuar, për shkak të mosmirëmbajtjes së tyre. Kam vizituar secilin fshat, i kam videot, është dashur me i bërë presion operatorit ekonomik, por nuk i keni bërë, se kontrata është vetëm 10 cent metra e rrugës, nuk mund të fitoni. Kjo është e jashtëligjshme, si keqpërdoret buxheti i komunës pa asnjë përgjegjësi.

**z. Arian Teneqja:** Një pjesë të sqarimit e dha drejtori i financave. Të pagesa që e bëjmë prej një kodi ekonomik për mirëmbajtje verore e dimërore të rrugëve lokale, janë 3 kontrata aktive të ndryshme dhe 1 kontratë tjetër për hapësirat gjelbëruese me KRM "Pastërtia". Shuma e pagesës vjen pre 3 + 1 kontratave. Paguhet mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale, mirëmbajtja verore e rrugëve lokale, mirëmbajtja e ndriçimit publik, mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese që e përmenda me KRM "Pastërtia" dhe Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal. Nuk janë krejt pagesat që i përmende 475 mijë euro, janë 4 kontrata.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Sa janë shumat e atyre kontratave?

**z. Arian Teneqja:** Duhet me i mbledhur, për sinjalizim 6,045euro, 333 mijë euro për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve, për ndriçim publik, 32 mijë euro, dhe për kontratën me KRM "Pastërtia" 61mijë euro. Kur të ti mbledhim del shifra e raportit financiar të mirëmbajtja e rrugëve lokale.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Drejtori i financave shumë mirë e sqaroj, mos dilni jashtë temës.

**z. Arian Teneqja:** Është i një kod që përfshin kontrata shumëvjeçare. Një pagesë është bërë në 2023-2024, një pagesë e kontratës është bërë 2024-2026. Askund nuk është tejkaluar kontrata.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Unë jam duke shikuar raportin 2025 dhe 2024, për shifrat 366 euro dhe 252 mijë euro, nuk jam duke folur për vitin 2023.

**z. Arian Teneqja:** Një kontratë ka qenë për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve, 475 mijë euro. Një kontratë ka qenë për sinjalizim, 75 mijë euro, një kontratë për mirëmbajtje të ndriçimit publik, 100 mijë euro. Këto janë kontrata kornizë që janë shumëvjeçare, për atë nuk iu dalin llogaritë juve.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Unë po e shoh vetëm këtë kontratën në prokurim, është kontrata për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve lokale. Kur e shoh në raport financiar, e shoh mirëmbajtja e rrugëve lokale, nuk e shoh sinjalizim. Ju e keni bërë kështu raportin, e keni kaluar shifrën e kësaj kontrate qysh është kontraktuar.

**z. Arian Teneqja:** Unë e sqarova se në atë kod ekonomik, bëhet pagesa për 4 kontrata. Pagesa për mirëmbajtje verore e dimërore të rrugëve lokale, pagesa për pastrimin e hapësirave gjelbëruese me KRM "Pastërtia", pagesa për mirëmbajtjen e ndriçimit publik. Janë 4 kontrata në veti, nuk është kjo një kontratë, por paguhet prej kodit ekonomik, mirëmbajtja e rrugëve lokale.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Pse nuk e bëni pastrimin e trotuareve në komunën e Kaçanikut, a dini gjendjen e tyre?

**z. Arian Teneqja:** Ajo kontratë ka një numër të pozicioneve, besoj se e keni pa, se është punuar shumë, ka qenë qeverisje e suksesshme, ka shumë rrugë, shumë trotuare, nëse ne tentojmë me i mirëmbajtur të gjitha, nuk na mjafton buxheti, por i mirëmbajmë në bazë të prioriteteve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mundesh me debatuar njëherë Ernesta dhe me replikuar, por jo sa herë të doni. I bërë pyetjet, i more përgjigjet nga drejtori. Drejtori i ka përfunduar përgjigjet, ndërkaq ti mundesh me fol, pasi nuk po ndalesh. Drejtor, nuk keni më çka me iu përgjigjur.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Nuk po me lini me vazhduar bisedën, se po iu vjen marre se qysh nuk keni pasur buxhet, a kontrata me i pastruar trotuaret është 10 cent metra.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mos e përdor këtë gjuhë, përgjigja ju ka dhënë, por juve nuk ju pëlqejnë përgjigjet.

**znj. Ernesta Krasniqi:** E ndalni diskutimin, se duam me ditur pse nuk pastrohen trotuaret.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Të shpenzimet kapitale, janë realizuar 4 milion euro, 250 mijë e 254 €, ndërkaq janë 277 mijë e 709 € janë mbetje për shkak të vonesave në prokurim dhe mos dorëzimit të punimeve me kohë. Pse kanë arritur këto vonesa në prokurim dhe a ka pasur mbikëqyrës të projekteve me dhënë llogari pse projektet janë vonuar, a ka ndëshkim për kompaninë nëse nuk i kryen punët në afat të caktuar. Kryqi i Kuq i ka ofruar komunës së Kaçanikut 2,400€ për ndonjë projekt, po ta kishin pasur gati komuna, e kishin fituar. Komuna nuk e ka pasur projektin, ato mjete nuk kanë arritur me u shpenzuar, janë bartur për vitin vijues, kështu na tha drejtori në KPF se nuk ka pasur projekt. Tani mundeni me bërë projekt dhe ato i financojnë.

**z. Valdrin Dogani:** Është një donacion i Kryqit të Kuq, drejtuar komunës tonë para shumë viteve. Donacionet nëse nuk shpenzohen, njëjtë si të HVK, bartën. Në momentin që Kryqi i Kuq e ka një projekt, si fjala vjen me DA për iniciativën me shkuar në shkolla fjala vjen, ne me ato mjete e paguajmë atë projekt, por vlera është e vogël, dhe nuk di çfarë projekti

mundet me u bërë, se me hyrë në një shkollë 100-200 nxënës, çka mundesh me bërë me ato mjete. Kryqi i Kuq dihet se çfarë kapaciteti ka dhe çfarë natyre të shërbimeve ofron. si trajnime për ofrimin e ndihmës së parë, për këtë qëllim këto mjete mundën me u shfrytëzuar.

**znj. Kadrije Lika Troni:** A ndëshkohen kompanitë që vonohen në kryerjen e punëve?

**z. Valdrin Dogani:** Po, janë dy raste, mundem me të treguar me vonë se cilat kompani janë. Të Investimet kapitale janë procedurat, shpallet tenderi, aplikojnë ofertuesit, procedura e ankesave, e merr lëndën OSHP, çdo gjë po vonohet dhe në momentin kur bëhet me u nënshkruar kontrata, ato mjete nuk ke mundësi më me i zotuar, se kalojnë limitet kohore dhe barten për vitin vijues.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kush është menaxher i kontratës për mirëmbajtjen e rrugëve dimërore dhe verore, se nuk po e shoh emrin, ndërkaq po me duhet për procedura të mëtutjeshme?

**z. Arian Teneqja:** Për momentin është Valmir Krasniqi.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Jam duke kërkuar për kontratën 470 mijë euro, jo kontratën që është bërë në vitin 2026, 10 mijë euro, se nuk është në material.

**z. Arian Teneqja:** Sa kam qenë zyrtar unë, kam qenë menaxher i projektit. Ju e keni ditur, por vetëm po doni me bërë pyetje. Nëse dinë me hyrë të e-Prokurimi, të kontrata e gjeni edhe vendimin. Ishte pyetje ironike, por nuk ka problem.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Të kontrata 2 vjeçare e cila është bërë në fillim të vitit 2024, nuk është emri i menaxherit të projektit dhe nuk është e nënshkruar.

**z. Arian Teneqja:** Pyetjen e bërë se kush është menaxher i mirëmbajtjes, unë të njoftova se është Valmiri. Kur me pyete se kush ka qenë menaxher i asaj kontrate, një pjesë kam qenë unë, ndërkaq një pjesë me marrjen e detyrës se drejtorit, është deleguar zyrtarit, Hajredin Shehu.

**z. Jeton Luma:** Drejtori i DSHPE i përmendi ndriçimin publik të mallrat dhe shërbimet. Drejtor e paske dërguar mesazhin, unë nuk e kam emailin zyrtar, në rregull, e lëmë që është gabim teknik. A mundeni me sqaruar, kush është kompania që mirëmban ndriçimin publik, që janë shpenzuar 32 mijë euro. Pse nuk intervenuar asnjëherë për gjatë tërë vitit në f. Glloboçicë, në dritat e dëmtuara në lagjen “Kodrali” dhe në rrugën “Fshati i Vjetër”.

**z. Arian Teneqja:** Me 12 shkurt e keni marrë Jeton përgjigjen detale në email në këtë pyetje, por mund të përgjigjem edhe tani direkt. Mirëmbajtja e ndriçimit publik bëhet përmes kontratës, është një kontratë që është në finalizim. Ne veç e kemi iniciuar kërkesën për kontratën e re, është intervenuar vazhdimisht ku kemi probleme ku ka pasur ankesa, të cilat bëhen përmes administratorëve - kryetarëve të fshatrave. Nëse e pyesni kryetarin e fshatit, ai të njofton se kemi intervenuar. Ka probleme në ndriçim publik, ta kam sqaruar edhe në shkresë, për shkak të luhatjeve, motit, ndërkaq intervenojmë në vazhdimësi në bazë prioriteteve.

**z. Jeton Luma:** Unë jam lindur e rritur në fshatin tim, vazhdoj me jetuar në Glloboçicë dhe i di shumë mirë problemet e fshatit tim. Nuk është intervenuar asnjëherë, të kam treguar në seancën e parë konstituive, të kam thënë drejtor se një shtyllë është dëmtuar dhe a keni mundësi me intervenuar? Përgjigja ka qenë: E kam kontaktuar administratorin dhe e keni pyetur: A është urgjente? Iu ka thënë se nuk është urgjente. Ajo shtyllë ende nuk është riparuar.

**z. Arian Teneqja:** Është e vërtetë se është dëmtuar një shtyllë, por ajo shtyllë nuk e ka dëmtuar komplet rrjetin, por vetëm atë dritë. Ajo rregullohet, tani e kemi kontratën në përfundim e sipër, dhe nuk kemi mundësi me intervenuar, jemi duke intervenuar vetëm në

pjesët kryesore. Me lidhjen e kontratës së re, normal se ajo rregullohet, rrjeti funksionon, vetëm ajo shtyllë nuk bënë.

**z. Jeton Luma:** Në lagjen "Kodralli", janë 10 drita të dëmtuara dhe nuk është intervenuar, këtë mundem të argumentoj me fakte.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, raporti nuk votohet. Konstatohet se Kuvendi i Komunës

#### NJOFTOHET

**Me Raportin Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025/Lënda:01Nr.400/01-4177/26.**

4.Raporti vjetor i Njesisë së Auditimit të brendshëm, për vitin 2025;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Islam Gashi:** Raporti në këtë formë, me shumë duket si një përmbushje, si një përshkrim administrativ, sesa si një vlerësim i kontrollit të brendshëm në komunë. Mangësitë kryesore të identifikuar janë se, raporti nuk jep një pasqyrim të qartë mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Nuk shuhet qartë se a është kontrolli i brendshëm plotësisht efektiv. nëse po, pse nuk është paraqitur, nëse jo, cilat janë dobësitë konkrete. Nuk ka gjithashtu vlerësim të rrezikut, nuk janë identifikuar apo treguar faktorët e rrezikut. Nuk janë identifikuar se cilat fusha janë me rrezikshmëri me të mëdha në komunë dhe cilat procese janë me të ekspozuara ndaj keq menaxhimit. Nëse auditor nuk i identifikon këto rreziqe, atëherë çka ka audituar. Tjetër është që rekomandimet janë të përgjithshme, jo të matshme, me tepër janë të formës menaxhmentit të përgatitet me kohë planet, trajtimi i vazhdueshëm. Rekomandimet zakonisht duhet me u lidhur me gjetjet, gjetjet duhet me ardhur si vlerësim i rreziqeve. Në raport tregon se janë kryer 5 auditime, ndërkaq në listë janë 6, është dashur me shënuar 5 auditime + 1 auditim rezervë sipas kërkesës. Të roli i komitetit, është përshkrim shumë i shkurtër, nuk e tregon çfarë vendimesh konkrete ka marrë raporti i auditimit dhe sa ka ndikuar në përmirësim të sistemit. Ajo që është me shqetësuese është se, në këtë raport të auditimit kemi konflikt të interesit dhe cenim të subjektivitetit apo pavarësisë së auditorit. Kryetar, jeni të vetëdijshëm se auditimin e ka kryer ish drejtoresha që ka qenë në mandatin e kaluar. Qysh mundet një auditore me audituar punën e vet ose proceset që i ka kaluar. Gjithashtu me duket se burri i saj është zyrtar në komunë. A i ka audituar edhe këto drejtori ? A mendoni që ky raport i auditimit të ofron siguri të mjaftueshme lidhur me kontrollin e brendshëm?

**Kryetari i Komunës:** Faleminderit Islam, po e kemi shikuar raportin e auditimit të brendshëm, që përmirëson neve në auditimin e jashtëm që janë të pavarur. Ne i marrim parasysh vërejtjet e juaja, edhe unë pajtohem me disa nga vërejtjet e juaja. Sa i përket konfliktit të interesit, janë organet tjera që munden me specifikuar.

**z. Islam Gashi:** Ligji 06/L-41, pika 4, thuhet se sipas standardeve, nuk mundet me kryer auditim në komunë, personat që kanë pozita vendimmarrëse në dy vitet e fundit.

**Kryetari i Komunës:** Auditorja i ka marrë disa mostra të dikastereve në komunë, i ka dhënë rekomandime, na ka treguar se cilat janë të zbatueshme dhe ato që janë në zbatim e sipër që kanë filluar, dhe ku duhet me u përmirësuar. Çështja e pranimit të auditores, konkursi ka qenë publik, kanë qenë kriteret, me pas qenë e kundërligjshme na ishte kthyer dhe ishte anuluar krejt procedura.

**z. Islam Gashi:** Nuk po e kontestoj atë pjesën pse është bërë auditore, por po e kontestoj çështjen e auditimit. Si mundet auditorja me i audituar proceset e veta? Kjo është konflikt i interesit? Qysh mundet me qenë objektiv, kur të auditon vetveten?

**Kryetari i Komunës:** Të pjesa që nuk mundet me audituar dy vitet e fundit, mundem me krijuar një procedurë të auditimit.

**z. Valdrin Dogani:** Të pjesa ku ka qenë e implikuar vet auditorja, kur të vjen Zyra e auditimit të jashtëm, i bënë kërkesë, ia tregon rastin që për atë pjesë me bërë auditim, Zyra kombëtare e auditimit.

**z. Islam Gashi:** Ky raport kështu qysh është, nuk ofron siguri as për kryetari as për neve anëtarët e KK, as për publikun që kontrolli i brendshëm është duke funksionuar si duhet.

**Kryetari i Komunës:** Sa për dijeni, për juve dhe për të gjithë qytetarët, se në dhjetë vitet e fundit pjesën me të madhe të raportit të auditimit e kemi pasur ndër me të mirët, kemi qenë përfitues të granteve, si rezultat i punës me performancës me të mirë të komunës tonë. Kjo po bien ndeshë se për ju nuk vlen asgjë që bëhet mirë, ndërkaq institucionet e pavarura na vlerësojnë mirë dhe si rezultat i kësaj ne ndajmë subvencione, përkundër se ishte dashur me pasur përfitime edhe nga ministria e linjës, nuk kemi pasur, kështu jemi detyruar me performancë të mirë të komunës, me bërë projekte të mira që janë të prekshme për qytetarët. Sa i përket transparencës, jemi në vendin e parë në vitin 2025. Raporti i auditorit na ka ardhur negativ, kur kemi pagua kontratën kolektive, e cila nuk ka qenë barrë e komunave, ka qenë një vendim i SBASHK, MASHT, MPFT, që barrë kryesore të nivelit qendror, ia kanë atribuar komunave, dhe për deri sa i kemi këto barrë të kontratës, raporti i auditorit normal del negativ, se kemi paguar dhe kemi me paguar edhe sivjet, për kundër se arsimtarët i meritojnë këto të hyra. Përndryshe auditorja është e pavarur edhe pse vepron në kuadër të komunës, ndërkaq në dhjetë vitet e fundit nga auditorët e jashtëm, jemi vlerësuar dhe kemi qenë përfitues të shumë granteve, të cilat i kemi realizuar për qytetarët e komunës tonë.

**z. Islam Gashi:** Nuk dua me diskutua raportet tjera të auditimit, ndërkaq këtë raport të cilin e ka bërë ish drejtoresha, një pjesë e raportit mendoj se nuk është shumë profesional, nuk ka rekomandime, janë shumë të thjeshta rekomandimet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, edhe ky raport kalon si informatë. Konstatohet se Kuvendi i Komunës

#### NJOFTOHET

Me Raportin vjetor i Njësisë së Auditimit të brendshëm, për vitin 2025/Lënda: 01Nr.104/02-3795/26.

5. Informatë për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor 2025-2026;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime E hapi diskutimin:

**z. Hestet Malsiu:** I pash tabelat dhe statistikat e paraqitur në informatë, ndërkaq me bënë shumë përshtypje ndryshimi shumë i lartë në përqindje i rezultateve pozitive nga shkolla fillore dhe shkolla e mesme e ulët. A keni nxjerrë vetëm statistika apo keni nxjerrë ndonjë përfundim sesi duhet me i përmirësuar këto rezultate? Ku janë shkaqet që bien kaq shumë rezultati e mos të flasim për shkollat e mesme, që rezultati bien edhe me shumë në përqindje?

**z. Gazmend Bunjaku:** Përshëndetje komandant, besoj se kështu njihesh edhe në publik. Sa i përket rezultateve, vlerësimi është në diskrecion të mësimdhënësve, raportet janë reale. Ne mundem fjala vjen me nxjerrë një raport jo real, me nxjerrë përqindje tjetër, por është me mirë me prezantuar raportin real sesi është gjendja në shkolla në terren sa i përket

rezultateve, dhe në bazë të atij raporti, me i bërë strategjitë dhe me i marrë veprimet e nevojshme. Unë mendoj se dallimi është se shkollat fillore, vlerësimi i nxënësve bëhet nga arsimtarët që ata e mendojnë notat që i meriton nxënësi. Ne e kemi të pamundur me ndërhyrë, edhe drejtori i shkollës dhe kushdo tjetër e ka të pamundur me ndërhyrë, se kjo është në diskrecion të mësimdhënësve. Ata që kanë punuar apo punojnë në arsim, e dinë sesi funksionon kjo çështje.

**z. Hestet Malsiu:** Unë nuk thashë se duhet me ndërhyrë në vlerësim, por e thashë se kjo statistikë, a iu ka detyruar me marrë hapa me përmirësuar gjendjen, me shpjeguar me në detale se ku janë shkaqet që ndryshon kaq shumë vlerësimi i nxënësve prej një kategorie, në kategorinë tjetër? Cilët janë hapat që keni marrë me përmirësuar këtë gjendje?

**z. Gazmend Bunjaku:** Edhe një herë po ndërlidhem të pjesa e vlerësimit të nxënësve që është diskrecion i mësimdhënësit. Unë i kam pa rezultatet, i kam analizuar, dhe besoj se edhe testi i arritshme risë së klasave të 9-ta ka me qenë konform këtij vlerësimi dhe ajo na jep një rezultat se vlerësimi i jashtëm nganjëherë është me real që na jep pasqyrën e notimit se çfarë gjendje kemi në shkolla në secilën lëndë dhe rezultati i përgjithshëm. Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me drejtorët dhe arsimtarët, ndoshta notat që është rezultati me i lartë kemi të cikli i ulët 1-5 dhe aty nëse mundem me quajtur aty është vlerësimi me i butë. Sepse bëhet me ma pak mësimdhënës dhe kjo e rritë notën mesatare në përgjithësi të shkollat fillore.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Nga raporti shihet se shkolla në f. Kovaçec, është pa emërtim, kjo është mjaftë shqetësuese. Ku ka mbetur çështja e emërimit të shkollës, a është në procedurë e sipër? E dyta: Është shqetësuese rënia e numrit të nxënësve të para fillorët, nga 248 fëmijë, janë 68 me pak në krahasim me vitin e kaluar. Në klasat e para 338 nxënës, janë 34 nxënës me pak sesa vitin e kaluar. Edhe në gjimnaz ka rënie të numrit të nxënësve, por kjo arsyetohet, se nxënësit po vijojnë mësimet në komunat tjera, apo edhe në SHMP. Kjo është një arsye e fortë, në mungesë të çerdheve, kam diskutuar edhe me juve drejtor, se ka raste që vijnë prind me rekomandim të mjekut për me u ri socializuar me fëmijët në çerdhe, dhe ata fëmijë duhet me i sistemuar, pavarësisht se numri i klasave është i mbingarkuar. Qysh e mendoni ju me bërë zgjidhje, se kemi shumë prind që janë të shqetësuar dhe presin përgjigje për sistemin të fëmijëve të tyre në çerdhe?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Merre si pyetje drejtor dhe nëse mundesh me iu përgjigjur menjëherë.

**z. Bashkim Krasniqi:** Sa i përket Informatës për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor 2025-2026, është një raport i detajuar dhe korrekt. Ne mundem me pasur vërejtje të suksesi, mungesat, me i identifikuar problemet dhe i përmirësuar ato. Ne sa herë kemi folur për problemet, por asnjëherë nuk kemi folur për një punë të mirë që bënë stafi arsimor. Unë i kam vizituar disa nga shkollat, në situatë me të keqe është shkolla "Ali Asllani" në Doganaj dhe shkolla "Emin Duraku", pasi foli kolegja nuk po foli për atë shkollë, kanë vërejtje njerëzit që na përfaqësojnë. Shkolla në Kaçanik të Vjetër, e kam vizituar, punon me një staf të mirë, shkolla është e mirë, duke iu falënderuar komunës që ka investuar. Gjithashtu dy shkollat e mesme, punohet shumë, puna që bëhet në këto shkolla, nuk bëhet në asnjë shkollë në territor të Kosovës. Shkolla në qendër, i përgatit nxënësit për fakultet, dhe nxënësit që dalin nga kjo shkollë kanë gjasat e mëdha me u pranuar në fakultet. Përveç vlerësimit që i ka bërë komuna, stafi aty kanë përfutuar edhe donacione dhe janë një ndër shkollat me specializuar në Kosovë, me tabela digjitale, etj. SHMP i përgatit nxënësit për tregun e punës, i kryen punët me sukses, është shkollë nga e cila nxënësit e saj me së tepërmi punësohen në KEDS. Ne mundemi me i identifikuar problemet, si me i zgjidhur at, por nuk mundem me anashkaluar punën e jashtëzakonshme që bëjnë stafi arsimor. Sa i përket rënies së numrit të nxënësve, krejt nxënësit që përfundojnë 9 vjeçare mendohet me

ardhur në shkolla të mesme këtu, por një pjesë e nxënësve të Begracës, Bajnicës Semajes, Gllaboçicës shkojnë në komunat tjera. Kjo dukuri është tentuar me u ndalë nga komuna duke ia siguruar transportin falas, unë mendoj se duhet cekur angazhimet e krejt vë dhe të stafit mësimor të dy shkollave të mesme për punën që bëjnë.

**znj. Ardita Brahmani:** Meritat për këtë raport i shkojnë ish drejtorit të kaluar, të cilin e falënderoj për një raport të detajuar. Shqetësuese është vit pas viti nataliteti-rënie e lindjeve, që ndikon në rënien e fëmijëve në kopsht dhe në shkolla. Drejtor, pas 6-7 muajve kemi me pasur raportin tjetër për përfundimin e këtij gjysmëvjetori. A iu inkurajuar Instituti i Shëndetësisë i cili dje e ka përgatitur një raport për ushqimin e fëmijëve parashkollor? Po mendoj përmes mekanizmave që ka DA, me i futur këto rekomandime për mirë-ushqyerje të fëmijëve që janë në kopsht, që për fat të keq është vetëm një kopsht me një numër të konsiderueshëm të fëmijëve. Në raportin e ardhëm është mirë me pa se ku jemi me ushqimin e fëmijëve në kopsht.

**z. Brahim Imishti:** Kam një sugjerim për drejtorin për me bërë një plotësim ndryshim rregullores, sa e di unë është e vitit 2018. Tani jemi në vitin 2026, ku ka dukuri negative që janë shfaqur të reja, dhe ato të vjetrat janë zvogëluar, që me bërë sa me të lehtë menaxhmentit të shkollës me marrë masa në raport me rregulloren. Secili nxënës që ndëshkohet, të jetë i informuar për veprimet negative që bëhen brenda dhe jashtë hapësirës shkollore, duke vendosur rregulloren në korridoret e shkollës, që secili nxënës që bënë një veprim, të dinë paraprakisht për veprimet ndëshkuese që mund të merren ndaj tij.

**z. Gazmend Bunjaku:** Për çështjen e emërtimit të shkollës së Kovaçecit, ne e kemi dorëzuar paraprakisht dokumentacionin e nevojshëm dhe e kemi bërë aplikimin. Ministria na ka njoftuar se njëri nga 3 anëtarët është në pushim vjetor. Në momentin që kthehet, kanë me marrë veprime të nevojshme dhe na njoftojnë. Besoj se gjithçka është brenda afateve dhe brenda procedurave. Kërkesa është në ministri, e kemi dorëzuar edhe emërtimin. Sa i përket çerdheve të fëmijëve, është i mbi ngarkuar me numër të fëmijëve, për këtë kemi pasur edhe një njoftim nga inspektori se numri është i mbingarkuar në raport me hapësirën, ndërkaq me staf jemi të plotësuar. Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në Rekë apo Verrishtë, besoj se ka me na lehtësuar punën dhe 40 fëmijë me i dërguar në atë çerdhe. Shpresoj ajo çerdhe të jetë e gatshme kah shtatori, duke pa punët sesi po zhvillohen. Nga mandati i kaluar, e dini se ka qenë e përfituar edhe një çerdhe për Kaçanik të Vjetër nga fondi IPPA të BE. Unë kam kontaktuar me ministrinë dhe ata me kanë garantuar se ajo çerdhe do të ndërtohet, varësisht nga afati që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare. Nga ana jonë e kemi siguruar parcelën dhe çdo gjë tjetër që është kërkuar, në momentin që lirohen ato fonde, ka me filluar ndërtimi i saj. Të SHMP, Buletin, tani quhen Institutet të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional-IAAP, nuk janë më shkolla profesionale. Sa i përket rënies së numrit të nxënësve, ka shumë faktorë, nataliteti, migrimi brenda vendit, emigrimi jashtë vendit etj. Ne e kemi bërë subvencionimin e transportit i cili direkt lidhet me shkollat e mesme, jemi të interesuar me i ndalë fëmijët brenda komunës, se në bazë të numrit të nxënësve përcaktohet edhe numri i arsimtarëve, nëse bien numri i nxënësve, ne rrezikojmë me mbetur pa punë arsimtarët. Tjetra është, çështja buxhetore për shkak të kontratës kolektive, po na penalizon, por nuk do të thotë që nëse nuk i kemi subvencionuar nxënësit jashtë komunës, në vitin tjetër do të shqyrtohen mundësitë për subvencionim. Disa nga drejtimet që na mungojnë, ne jemi duke shqyrtuar mundësitë për hapjen e tyre, besoj se brenda mandatit do të realizojmë. Ardita, sa i përket raportit të ISHP, jam interesuar edhe për ushqimit. Aty nuk ka ushqime të konservuara, kjo është e mirë, ka ankesa për pagesën 40€ se është e vogël, ndërkaq me ndryshuar në një komunë të varfër, nuk e di sa është në interesin publik kjo. Sa i përket pyetje se Brahimin, janë bërë ndryshime në rregullore, kryesisht përdoren rregulloret 2021

dhe 2023 që përcaktojnë masat ndëshkimore të cilat përcaktohen edhe nga kodi i mirësjelljes së shkollave. Ne jemi përkrahës të gjithë atyre që duan me vendosur disiplinë në shkollë, gjithë stafi i shkollave jemi në koordinim, unë e njoh problematikën- natyrën e problemeve të shkollave, se vijë nga ajo fushë, ajo që duhet ritheksuar, është bashkëpunimi me prindër, besoj që është qelës i suksesit në shkollë. Arsimit është institucion kompleks, që kërkon angazhim nga gjithë ne, kryetari, ekzekutivi, anëtarët e KK pa përjashtuar edhe përgjegjësinë e nivelit qendror, duke filluar nga presidentit, kryeministrit etj. Ajo që duhet me u shqetësuar është, rënia e numrit të fëmijëve, nxënësve në komunë, kjo është një strategji që kërkon një hulumtim pak me të gjatë për me ardhur deri vendimet që na ndihmojnë me përmirësuar këtë çështje.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Një nën pyetje për drejtorin: Nxënësit e f. Llanishtë a po subvencionohet 100% apo 50%. Në mandatin e kaluar kam kërkuar me u subvencionuar 100%, që mos me i mbetur barrë prindit.

**z. Gazmend Bunjaku:** Besoj që në këtë vit do të subvencionohen 100%.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Do me thënë ata janë ende barrë e prindërve. Pavarësisht se shkolla është mbyllur në Llanishtë, ne ua kemi obligim nxënësve shkollimin.

**z. Gazmend Bunjaku:** Fjala është për transportin.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Për transportin e kam fjalën, a e paguan 50% të transportit, prindi?

**z. Gazmend Bunjaku:** Me herët nuk ka pasur mundësi me bërë ndryshime, për shkak të mosmiratimit të buxhetit, tani kemi mundësi e ndryshojmë dhe i mbulojmë krejt shpenzimet e udhëtimit të atyre nxënësve.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Ka edhe nxënës të f. Runjevë dhe një pjese të Saniteksi, shumë prindër me janë ankuar për shkak të qenve endacak, fëmijët shoqërohen nga njëri prind.

**z. Gazmend Bunjaku:** Sipas rregullores në fuqi të ministrisë së Arsimit, transporti i nxënësve bëhet në relacion mbi 4 km.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Rregulloren duhet me sjellë në rishqyrtim, nëse ne mendojmë që nxënësit me ndenjuri në shkollat tona, duhet me iu ofruar kushtet, për mos me ra numri i nxënësve. Nxënësit e Llanishtës dhe Sankteksit, mund të shkojnë në Ferizaj me jetuar dhe ne nuk kemi arsye me menduar pse po kemi rënie të numrit të nxënësve.

**z. Gazmend Bunjaku:** Ne vetëm sa kemi filluar, mendoj se brenda vitit dhe brenda mandatit me i përmirësuar kushtet. E potencova se ky problem kërkon një strategji me afatgjatë dhe me u marrë krejt me këtë çështje për me marrë vendime.

**z. Buletin Guri:** Kam një pyetje për drejtorin: Meqë foli për përmirësimin e kushteve nëpër shkollë, A ka komuna apo ekzekutivi ndonjë plan konkret për çështjen e mungesës së psikologëve në shkollë?

**z. Gazmend Bunjaku:** Numri i psikologëve nëpër shkollë është i përcaktuar në bazë të numrit të nxënësve që ka komuna. Kemi psikolog që funksionon për 2-3 shkollë, sepse ashtu janë kriteret. Nevojë shoqëria jonë ka për psikolog, logoped, por nuk kemi mundësi buxhetore për krijimin e vendeve të reja të punës. Me rritjen me mundësive buxhetore, ne kemi me rritur edhe numrin e psikologëve dhe logoped në të gjitha shkollat.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Informata e DA nuk votohet, Konstatohet se Kuvendi i Komunës

#### DISKUTOJ

**Informatën për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor 2025-2026/Lënda: 01Nr.610/01-1931/26.**

6. Propozim Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Faik (Rufat) Muça;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin;

**z. Enis Vishi:** Meqë pika 6 dhe 7 janë të ngjashme, atëherë kam disa pyetje për këto dy pika. Para se të votohen këmbimi i pronave komunale, duhet të kemi përgjigje të qarta dhe konkrete se, cili është interesi i drejtpërdrejtë i komunës dhe çfarë përfitimi real marrin qytetarët nga ky këmbim? A ekziston plan i qartë zhvillimor për atë pronë dhe a është i paraparë projekt konkret dhe mbi të gjitha, a është ndarë buxhet për realizimin e tij?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për sqarime, fjalën e ka drejtori i DUKMM, Korab Krasniqi.

**z. Korab Krasniqi:** Çështja ka kaluar procedurën e shpalljes së interesit, ka shkuar në ministri për vlerësim financiar, lënda është kthyer pa pasur asnjë vërejtje deri me tani. Për me qenë me e lehtë për juve, unë e kam paraqitur edhe me skemë se cila pjesë do të epët dhe cila do të merret. Në këto raste kur kemi të bëjmë me këmbimin, komunë me persona privat, janë raste kur personave privat iu pengohet qasja në rrugë ose diçka të tillë dhe kur nuk e penalizon komunën për një këmbim të tillë. Si rregull, këmbimet janë bërë brenda zonës së njëjtë kadastrale, jemi fokusuar me qenë afër këto prona- me u kufizuar, kështu që ky këmbim, besoj se i plotëson të gjitha kriteret me u realizuar, përndryshe nëse kishte pasur diçka jo në rregull, ishte kthyer prej ministrisë si jo e rregullt. Me ngjyrë të kuqe mundeni me pa pjesën e parcelës që ka me u marrë nga personi fizik dhe pjesa e gjelbër, është pjesa që ka me marrë komuna. Sipërfaqet janë të vogla 60m<sup>2</sup>, dhe nuk besoj se kërkohet ndonjë plan për këto sipërfaqe të vogla. Ndoshta e keni ndërlidhur çështjen me dhënien e pronave në shfrytëzim- afatgjatë, në ato raste kërkohet një plan investiv. Ndërkaq për këtë rast nuk kërkohet diçka e tillë.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kjo pjesa e gjelbër, a është rrugë?

**z. Korab Krasniqi:** Kjo prona poshtë, është komunale, nuk është rrugë. Kjo pjesa e gjelbër e pronës fillimisht i takon një personi fizik, tani ka me u këmbyer me këtë pjesën këtu ku është rruga, qasja në rrugë, se ia pengon kësaj parcele qasjen në rrugë prona komunale. Prona komunale është para pronës së Faik Muça, zgjatet para pronës se tij me ia krijuar qasjen dhe nuk është diçka që e pengon me ia dhënë qasjen dhe nuk e dëmton komunën dhe raportit i m<sup>2</sup> i këmbimit është i barabartë. Prezantimin drejtori e bëri përmes tabelave digjitale.

**z. Heset Malsiu:** Fillimisht kur i kam pa skicat, me janë dukur të paqarta. Për ne duhet me qenë me të qarta këto këmbime, se ne nuk jemi profesionist të fushës me i kuptuar. Në këtë rast siç po shihet, ne po e mbrojmë interesin e një personi privat e jo interesin e komunës. Cili është interesi i përgjithshëm i komunës në këtë rast?

**z. Korab Krasniqi:** Keni të drejtë z. Malsiu, për atë e përgatita lëndën në këtë format për prezantim. Është në interesin e komunës besoj me iu dhënë qasje në rrugë të gjitha pronave që nuk kanë qasje, për me hyrë në pronat e veta, se përndryshe ai ashtu kështu ka me hyrë përmes pronës së komunës në pronën e vet. Kështu komuna e këmben me një pjesë të vetën dhe e zgjidhë një problem edhe për personin fizik edhe për komunën.

**z. Heset Malsiu:** Me vjen keq, por arsyeimi nuk është bindës për mua.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne jemi me iu dhënë qasje dhe mundësi qytetarëve.

**znj. Ernesta Krasniqi:** A është shtëpia e personit privat në parcelën e vet, ndërkaq ne po ia krijojmë qasjen në rrugë?

**z. Korab Krasniqi:** Unë nuk kam informatë se ka shtëpi aty. Ka shumë shtëpi që ndërtojnë pa pasur rrugë, nuk është ky rasti i vetëm.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Vendimi për shpallje interesi ka shkua në ministri, ekspertët kanë dalë në vendngjarje dhe e kanë shikuar terrenin dhe ia kanë dhënë dritën e gjelbër për këmbim. Çështja e këmbimit është faza përfundimtare.

**z. Korab Krasniqi:** Arsyesh mëria e vlerësimit të pronës është bërë në vitin 2024, kur është propozuar kjo pronë me u shpallë me interes. Ju Ernesta keni qenë pjesë e KK dhe është dashur me pasur këtë informatë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ernesta e kemi votuar shpalljen e interesit, ju keni qenë pjesë e KK. Ky këmbim bëhet për me i krijuar qasje qytetarit për me kaluar në pronë e vet.

**znj. Ernesta Krasniqi:** A është përmbushur ajo qysh e kemi votuar?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për derisa ministria e ka vlerësuar, ia ka dhënë dritën e gjelbër, ne përse mos me kaluar.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Arsyetimi i drejtorit, nuk është bindës.

**znj. Ardita Rrahmani:** Nuk e kam idenë për personin që po kërkohet me u këmbye prona e tij se nuk e njoh, nuk kam kurrfarë lidhje me të. E kam një thirrje, ne jemi këtu me ua bërë jetën me të lehtë qytetarëve. Nëse na vjen një kërkesë për qasje në rrugë, nëse ekziston mundësia, pse mos me aprovuar atë kërkesë. Idenë nuk e kam ku është kjo pronë, jam duke folur në aspektin e përgjithshëm, por vlen për secilën pronë, nëse ka hapësirë komuna me ia lehtësuar jetën qytetarëve, si qasjen në rrugë, komuna pa shkelë asnjë akt të vetin, atëherë pse mos me bërë.

**z. Hestet Malsiu:** Ardita, edhe në jemi për me ia lehtësuar jetën qytetarëve, mirëpo interesi i komunës duhet me u mbrojtur. Duhet me formuar një komision nga secili grup politik dhe me dalë në vendngjarje me pa gjendjen, që ne me ditur me dhënë mendimin këtu, se ne përmes skicës e kemi pak problem, se mundemi me i hyrë në hak personit apo komunës. Është mirë me formuar një komision, me dalë në vendngjarje, që ne me pa gjendjen aty.

**znj. Ardita Rrahmani:** Është një propozim i mirë që po e jepni ju, por deri sot nuk ka kemi pasur një komision të tillë.

**znj. Hafize Sallahi:** Unë pak a shumë e di për ku bëhet fjalë, por pajtohem me kolegën time, se ne jemi votuar nga qytetarët dhe jemi me iu bërë zgjidhje qytetarëve. Nëse nuk jam gabim, kryesuesi mundet me ditur, pronat janë të xhamia e fshatit, aty ku banon kërkuesi i kësaj prone, dhe neve nuk na pengon asgjë ky këmbim, sepse për momentin pronari kalon nëpër pronën e komunës. Duke pasur parasysh faktin se është një hapësirë e vogël, nuk na pengon asgjë, komuna nuk besoj se mundet me realizuar diçka në atë pronë. Unë jam me i bërë zgjidhje atij pronari, pavarësisht a banon apo do të banon në të ardhmen aty.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është e vërtetë se krijohet një qasje e mirë, i inkurajoj të gjithë qytetarët që kanë afër pronën komunale dhe kanë ndonjë pengesë për qasje në pronën e tij, jam për me iu dhënë qasje të gjithëve. Ne jemi për këtë këmbim, pasi që kjo çështje i ka kaluar procedurat paraprake, iu ka dhënë drita e gjelbër, besoj se nuk kemi arsye mos me votuar.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Kryesues, kur po thonë se jemi këtu me iu dhënë qasje të gjithëve, ju e dini shumë mirë që banorët e lagjes time e kanë kërkesën që dy vite të deponuar, po e njoftoj edhe drejtorin, ata kanë shprehur vullnetin që pronën private t'ia japin komunës për interes publik, ndërkaq komuna jonë nuk ka interesim as me dalë me i bërë matjet. Drejtor, të dërgoj unë formën dhe shikoje, që të del një ekip e juaja apo edhe ju vet, me shikuar a i plotëson kushtet ajo pronë, a ka interes komuna me marrë pronën private. Kur është në pyetje që qytetari po shprehë vullnet me i dhënë pronë komunës me shndërruar në pronë publike, ne po hezitohet. Unë jam kundër këtij këmbimi, edhe pse nuk e di se ku i bien dhe si është gjendja e këtyre pronave, ne jemi këtu me mbrojtur interesin publik.

**z. Korab Krasniqi:** Kur një qytetarë shpreh dëshirën me i dhënë pronë komunës, ai mundet me u paraqitë në Zyrën e kadastrit. Duhet me pasur Fletën poseduese, letërnjoftimin, kjo është procedurë e thjeshtë, e nënshkruan se e kalon pronën në pronësi të komunës dhe nuk

ka nevojë me dalë askush në terren. Nëse kërkon diçka në këmbim, atëherë është procedurë me e gjatë.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Nuk është për këmbim. Kërkesa është e protokolluar, unë ju dërgoj numrin e protokollit dhe ju e shikoni atë pronë. Komuna nuk e ka pasur vullnetin për me iniciuar atë kërkesë.

**z. Korab Krasniqi:** Kurdo që ka kohë pronari në fjalë, vjen në zyrën time dhe unë e kryej si procedurë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim Propozim Vendimin dhe i njëjti u aprovua me 13 Për, Kundër 6, 2 Abstenime. Prezentë 21. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

#### VENDIM

**Për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Faik (Rufat) Muça/ Lënda:01Nr. 104/02-4196/26.**

7. Propozim Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Isen (Agush) Raka;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Korab Krasniqi:** Këtu është një rast tjetër, edhe këtu kemi parcelën e komunës që ia ndalon qasjen dy pronave të personit fizik. Në vazhdim drejtori e sqaroi, pjesën e pronës së personit fizik që e merr komuna, dhe pjesën e pronës komunale që jepet në këmbim.

**z. Jeton Luma:** Të pika 9, e rendit të ditës, na keni sjellë edhe në formë satelitore, ndërkaq për këtë pikë jo. A mundeni për mbledhjen vijuese me na e siguruar në formë satelitore?

**z. Korab Krasniqi:** Varësisht qysh është përgatitur lënda, se në ministri nuk kërkohet në atë formë, janë numrat e parcelave dhe në gjeoportal gjinden.

**z. Jeton Luma:** Pika 9 a kërkohet në ministri?

**z. Korab Krasniqi:** Të pika 9 e kam përgatitur se janë pronat për shpallje interesit dhe për me ua bërë juve me të qartë, e kam përgatitur në këtë formë.

**z. Jeton Luma:** Unë mendoj që edhe kjo pikë është dashur të paraqitet në formë satelitore, që me qenë me e qartë për të gjithë anëtarët këtu, ashtu qysh e përmendi kolegu në fillim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Jeton, edhe kjo lëndë i ka kaluar procedurat në ministri.

**z. Korab Krasniqi:** Mundem me ua siguruar edhe në atë formë.

**z. Betim Shala:** Po ia bëjmë me dije drejtorit se është duke dalë pak nga rendi i ditës, se çështjen e interesit nuk e keni nevojë me sqaruar këtu. Interesi i kësaj prone, ka kaluar në mbledhjen e kaluar. Tani jemi duke diskutuar vetëm për pjesën e këmbimit, nuk mundemi ne me ndal këmbimin për pronat të cilat i kanë kaluar të gjitha filtrat e zonës me interes, nuk ka nevojë me u sqaruar me çështja e shpalljes me interes të asaj prone.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për derisa ka anëtarë të rinj të KK, është mirë me u sqaruar.

**z. Haset Malsiu:** Kam një reagim. Nëse është shpallë ajo pronë me interes, e ne nuk e kemi ditur me cilën pronë bëhet këmbimi, kur të vjen çështja e këmbimit, atëherë vendosim. Nëse këmbehet prona e komunës që ka me shumë vlerë sesa prona e personit privat, atëherë nuk kemi llogari me këmbyer, se nuk është në interes të komunës. Ju e keni shpallë atë zonë me interes në këmbim, por atë pjesë ku e jep në këmbim, duhet me ditur se çfarë vlere ka.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E ka vlerën prona që këmbehet.

**znj. Ardita Rrahmani:** z. Malsiu, juve iu falet që jeni anëtarë të rinj të KK, ndërkaq neve që kemi qenë anëtarë edhe në legjislaturën e kaluar, duhet me ditur çka kemi votuar dhe atë

informatë me shpërndarë të kolegët e grupit. Anëtarët e rinj kanë të drejtë të reagojnë, se nuk e kanë informatën, ndërkaq ne që e kemi votuar dhe e dimë që lënda ka kaluar të gjitha filtrat, nuk ka nevojë për informata shtesë.

**znj. Kadrije Lika Troni:** E falënderoj drejtorin që është duke na krijuar qasjen me të mirë për ne dhe për qytetarët, me ditur se çka po punojmë ne këtu, dhe e shoh si hap i avancuar. se ishte duke u prishur televizori pa u përdorur fare.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Isen (Agush) Raka, e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti 13 votë Për, Kundër 6, Abstenime 2. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Isen (Agush) Raka/Lënda: 01Nr. 104/02-4198/26.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pika 8 është hequr. Kalojmë të pika 9:

9. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik të parcelave kadastrale në Z.K në Kaçanik dhe në Z.K Bob;

Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Jeton Luma:** Ky Propozim Vendim ka ardhur në pako, bëhet fjalë për parcela të ndryshme, me pronarë të ndryshëm dhe interesa të ndryshme. Secila parcelë është dashur të vijë si pikë e veçantë e rendit të ditës, në mënyrë që të trajtohet në mënyrë sa me të duhur. Në arsyetim thuhet se komuna nuk do të ketë barrë financiare, por do të jap bonus për leje ndërtimore. Këtu ka paqartësi, çka është ky bonusi? Sa është vlera e tij? Cila parcelë fiton dhe në çfarë mase fiton? Nëse ka mundësi me na dhënë sqarime drejtori apo dikush tjetër.

**z. Betim Shala:** Ne si LDK e përkrahim këtë Propozim Vendim, zgjerimi i rrugës "Qamil Ilazi" është i nevojshëm. Kyçja e banorëve nga f. Bob në qytetin e Kaçanikut me një rrugë të re, mendojmë se është i nevojshëm. Mendoj se duhet ta përkrahim këtë Propozim Vendim.

**z. Heset Malsiu:** Të këta projekte edhe ne jemi Për, se duhet të bëhet zgjerim i rrugëve, trotuareve, të ndërtohet, që qytetarët tonë me pasur ku me blerë, e mos me shkuar me blerë në qytete tjera e me u shpërngulur nga këtu.

**z. Korab Krasniqi:** Nuk ka rregullore për bonueset, në mungesë të saj formohet një komision. Nëse kërkon leje ndërtimi personi fizik apo juridik, pjesa e pronës që kalon në pronë komunale, zakonisht këmbëhet me etazhitet në ndërtim. Unë i kam paraqitur këtu të gjitha skemat, me iu treguar pse janë të rëndësishme për komunën dhe pse duhet të përkrahen nga ju. Pjesa e ZK në Kaçanik është të rruga "Qamil Ilazi", e kemi bërë si kriter që nëse dikush kërkon leje për ndërtim, të largohet nga rruga 7m në vijë ndërtimore kryesore, ndërkaq në dytësore, 4m. Në këtë rast është e paraqitur me vijën e verdhë pjesa kufizuese e parcelës, ndërkaq vija e kuqe ku duhet me u larguar objekti me pas.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Largimi nga rruga ndërtimi i objektit, a nuk është e përcaktuar kjo me ligj? Sa është me ligj e paraparë me u larguar nga rruga?

**z. Korab Krasniqi:** Nuk është 7m, ne kemi dashur me i rritur hapësirat publike.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Është me shumë se 7m, dhe me shumë se 4m në zona dytësore.

**z. Korab Krasniqi:** Nëse e keni fjalën për magjistrale, se jemi duke folur për një zonë në mes të qytetit. Betimi është profesionist i fushës dhe është me kompetent, nuk ka rëndësi a është drejtor apo jo, e njeh ligjin, mundet me dhënë informata të nevojshme.

**z. Betim Shala:** Vijat ndërtimore, vijat rregulluese i përcakton plan rregullues. Komuna për momentin plan rregullues në fuqi, e ka vetëm për f. Strazhë. Të pjesa e rrugës "Qamil Ilazi", mundemi me punuar vetëm me ligjin për ndërtim, nenin 17 dhe 18 që përcaktojnë kushtet ndërtimore, në diametër 50 metra, atëherë je i obliguar me lëshuar leje ndërtimore aq sa janë larg nga rruga banesat që janë në këtë pjesë, me ikur kah pjesa tjetër. Komuna është e detyruar me marrë një vendim për zgjerimin e rrugës, pastaj me vepruar me kushtet e njëjta të rrugës-kufirin e rrugës. PZHK i cili është në fuqi dhe PZHU nuk përcaktojnë as vija ndërtimore as vija rregullative, as etazhi-tetin. Ato janë plane strategjike hapësinore. Kushtet tjera i cakton, Harta zonale dhe Planet rregulluese. Për këtë zonën kah pjesa tjetër, ka qenë një plan rregullues 2012-2017 për 5 vite. Në këtë rast, komuna mundet me lëshuar leje vetëm në bazë të nenit 18.

**z. Jeton Luma:** Ne jemi për zgjerimin e rrugëve, zhvillimin e infrastrukturës, por këtë konsideroj të paqartë dhe jo transparente. Ajo që duhet me iu vendosur theks i veçantë, është çështja e bonusit. Sipas ligjit 03/l-131 për shpronësimin e pronës së paluajtshme thuhet: "Pronarët e pronës që iu merret prona për interes publik, duhet të kompensohen me vlerën reale të tregut". A mundeni me na treguar, qysh e ekzekutoni bonusin?

**z. Betim Shala:** Vendimi për bonuse është bërë në vitin 2021, kam qenë pjesë e ekzekutivit. Kryetari vendimin për bonuse, e ka marrë duke u bazuar në procedurat si kanë vepruar kryetarët e komunave në krejt Kosovën. Ne e kemi marrë për bazë vendimin e komunës së Prishtinës, ish kryetari -Isa Mustafa, i cili ka marrë një vendim kur komunës iu ka dashur për rrugë, me kompensuar me kate-etazhe. Aty janë do kushte, vendimin e ka zbatuar ish kryetari, Shpend Ahmeti, ish ministri i infrastrukturës Liburn Aliu, vendim të njëjtë ka marrë edhe ish kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri në Gjilan dhe është duke u zbatuar tani. Për ligjshmërinë e këtij vendimi, ekziston një vendim i Prokurorisë në Ferizaj. Unë kam qenë pjesë e komisionit për ndryshimin e kateve me tokë, Prokuroria e ka hedhë poshtë kallëzimin penal dhe thekson se komuna ka të drejtë me zgjedhur formën me të favorshme të kompensimit. Forma me e favorshme për komunën është me dhënë me etazhe, se e rritë ndërtimin dhe ai ka me i paguar taksat, plus komuna nuk paguan mjete. Me gjykatë në këtë vend gati se ka arritur 100 mijë euro ari.

**znj. Ardita Rrahmani:** Jam shumë e lumtur që jam pjesë e kësaj legjislature, ku zhvillimi i ndërtimit të lartë po merr hov, sidomos tani. Si LDK dhe si Ardite kam kërkuar me u zbatuar ligji i ndërtimit, pasur parasysh se kemi mungesën e PZHK të ri komunal. Jam e lumtur që sot kam mundësi me votuar këtë vendim, me i jep hov zhvillimit të qytetit, me tentuar me ndal pak migrimin e qytetarëve në vende tjera, përndryshe shkojmë në rënie të popullsisë.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Edhe pse jemi prapa me zhvillim të ndërtimit të lartë, ne prapë jemi me të njëjtin PZHK. Pse me herët kemi pasur këtë ngecje, tani po i japim hov zhvillimit të lartë të ndërtimit? Ne jemi me i dhënë hov zhvillimit të ndërtimit të lartë, por qysh e potencoj Jetoni, parcelat nuk është dashur me ardhur në pako, por të ndara. Nuk e kam të qartë të parcela New Lepenci -2 sh.p.k, qira-mbajtje 99 vite, qiramarrje Castle City L.L.C., kjo krijon paqartësi. Kush është përgjegjës për negociata me komunën, pronari apo qiramarrësi? Qiramarrësi a ka të drejtë?

**z. Korab Krasniqi:** Besoj se këtu nuk ka dilema, ai që e ka i fundit pronën i zhvillon negociatat dhe i bënë kërkesat. Kjo pronë nuk është dhënë në shfrytëzim nga komuna, është blerë direkt prej AKP, kështu që nuk ka kurrfarë telashe.

**znj. Kadrije Lika Troni:** A është blerë ajo pronë për 99 vjet?

**z. Korab Krasniqi:** Po, kjo nuk është pronë komunale, trajtimi shkon ndryshe. Pronat e AKP mundën me kaluar edhe të personi i tretë, ndërkaq pronat që jepen nga komuna, nuk mundën me kaluar në personin e tretë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Këtu është edhe rruga që lëshohet për f. Bob. Nëse mundesh me ua sqaruar, është mirë.

**z. Korab Krasniqi:** Po, mundet me sqaruar edhe Kjaniu, se është me kompetent.

**z. Kjani Zeneli:** Unë në parim e kam mbështetur si projekt, zgjerimin e rrugëve të "Qamil Ilazi" dhe të rrugës në Bob. Unë e di problematikën e rrugës Bob, jemi modernizuar me shumë, përpara kemi qenë fshat, tani jemi duke u bërë si lagje urbane, e përgëzoj Kaçanikun për projekte të ndërtimit të lartë. Interesi i komunitetit tonë është se ne e kemi një qasje shumë të rrezikshme me u kyçur në magjistrale, ka pasur edhe fatkeqësi vite me herët. Si interes i komunitetit të Bobit është, me u zgjeruar rruga 6 metra dhe dalja këtu në qytet. Të pjesa e ndërtimit që ka me bënë kompania, shpresojmë se e realizon mirë projektin. Interesi i komunitetit është i madh, se ne e kemi shumë problematikë rrugën për me u kyçur për me ardhur në qytet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimi për shpallje me interes publik të parcelave kadastrale në Z.K në Kaçanik dhe në Z.K Bob, e shtrij në votim për aprovim dhe i njëjti u miratua me 14 votë për, kundër votë nuk ka, Abstenuan 6. Prezentë në sallë kur u votua çështja ishin 20. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori

#### VENDIM

Për shpallje me interes publik të parcelave kadastrale në Z.K në Kaçanik dhe në Z.K Bob/  
Lënda: 01Nr. 104/02-4631/26.

10. Raporti për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara të reshurat e borës 02.10.2025 dhe të reshurat e shiut 24,25.11.2025;

10.1 Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e borës në Llanishtë, të fermeres Ramize Axhami;

10.2 Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e borës në Stagovë, të fermerit Hajdin Teneqja;

10.2 Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut në Bob, të fermerit Hestet Kuka.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në kuadër të kësaj pike janë bërë janë tre nënpikë, të cilat do të votohen të veçanta. Pika 10.1 dhe 10.2 kanë qenë me një pikë dhe janë ndarë nga KPF. Tani i kemi nënpikat: 10.1, 10.2, 10.3. E hapi diskutimin:

**z. Hestet Malsiu:** Parimisht jemi për me i subvencionuar bujqit, në këtë rast jemi për me i ndihmuar këta familje që iu kanë shkaktuar dëme. Ajo që me ka bërë përshtypje, janë dy gjëra: 1. Raportet janë punuar në mënyrë jo të kujdesshme. 2. Të çështja e fermerit Hestet Kuka, nuk iu ka vlerësuar lakra. Në muajin nëntor nuk mund të konsiderohet se lakra është dashur me u shitur në treg. Lakra është një bimë që mund ti qëndroj të ftohtit, e sidomos këtij dimri, kur dihet se ka ende lakra nëpër ara të padëmtuara. Mendoj se i është bërë e padrejtë Hestet Kukes që nuk iu ka vlerësuar lakra. Të arrat, të raporti është pak sa e çuditshme, e potencova se raporti është hartuar në mënyrë jo të kujdesshme. Në pikën e parë thuhet se është dëmtuar prej borës, në pikën e dytë thuhet, duke iu referuar pikës së parë, është dëmtuar prej breshëri. A janë dëmtuar prej borës apo breshëri? Në dokumente zyrtare duhet me qenë me të kujdesshme, me ditë se çka po shkruhet. Në muajin tetor, nuk mund të

dëmtohet fryti i arrës nga asnjë e reshur atmosferike, aq me pak nga bora që ka qëndruar vetëm 2 ditë. Të paguhet fruti i arrës për dëmtim nga bora, e mos të paguhet lakra që iu ka dëmtuar nga vërshimet, është një standard i dyfishtë i vlerësimit. Fidanët shihet se janë dëmtuar, ndërkaq mendoj se janë vlerësuar me pak, sesa çmimi real në treg, ndoshta duhet të vlerësohen me mirë. Fruti i arrës nuk mund të vlerësohet në tetor, sepse është i pjekur në atë kohë.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Ne si grup i LVV i mbështetim fermerët për subvencionim të komunës dhe të qeverisë, ndërkaq nuk e kam të qartë, dëmet janë shkaktuar në muajin tetor, kërkesa na vjen në muajin shkurt. Pse janë vonuar kaq shumë këto lëndë?

**z. Suhad Dullovi:** Të pyetja e Heset Malsiut, për z. Heset Kuka, ka qenë një vonesë e fermerit që nuk ka bërë heqjen e lakrës nga parcela e tij. Dëmi ka qenë me 25-26 nëntor 2025, kapaciteti i fermerit ka qenë me hequr lakrën dhe me pozicionuar në diku në një ambient të mbyllur për ruajtje, pastaj të shitet në treg, nëse nuk ka pasur treg me pakicë. Të Ramize Axhami, fillimisht ka ra breshëri gjatë ditës, pastaj ka filluar me ra bora në mbremje dhe ia ka dëmtuar sipërfaqen e arrave, janë vlerësuar nga komisioni vlerësues. Ramize Axhami ka bërë kërkesë edhe për molla, lajthia. Sipas vlerësimit të komisionit, mollët dhe lajthitja nuk iu kanë dëmtuar. Të pyetja e Kadrijes, ne nuk kemi mundur me marrë veprime me herët me i proceduar lëndët, se kemi qenë në kohë të zgjedhjeve lokale. Në takimet me Agjencinë e Emergjencave, e kemi marrë dritën e gjelbër, pasi nuk ka qenë KK i inauguruar, mundeni me proceduar tani çështjen e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Drejtor, nëse ka qenë kohë e zgjedhjeve, ne kemi qenë kuvend në detyrë. Nëse ka pasur diçka emergjente, ka pasur mundësi me u iniciuar çështjet, ju drejtorët keni qenë deri në fund, ne anëtarët e KK kemi qenë anëtarë deri me formimin e këtij KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sa e di unë, KK gjatë zgjedhjeve, nuk ka pasur të drejtë të merr vendime.

**z. Suhad Dullovi:** Nuk kemi pasur të drejtë me proceduar për KK, për shkak të fatkeqësive.

**z. Heset Malsiu:** Nuk e mora përgjigjen, qysh ka pasur mundësi me u dëmtuar fruti i arrës në muajin tetor. Nëse lakra ka qenë e pjekur, është dashur me dalë në treg në muajin nëntor.

**z. Suhad Dullovi:** Dëmtimi i arrave ka qenë me 02 tetor, i lakrave me 26 nëntor. Dallimi i klimës dallon, komisioni vlerësues ka shikuar edhe pjesën e lakrës në sipërfaqe të hapura, që për shkak të lagështisë, ka ardhur deri të deformimi-kalbja e tyre. Fruti i arrës ka qenë i dëmtuar, në momentin që ka qenë bora e lagur, i ka dëmtuar frutat dhe degët e arrës, të cilat fermeri ka kërkuar me iu kompensuar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Propozim Vendimin 10.1 e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua me njëzëri. Prezentë 20. Konstatohet se Kuvendi i Komunës merr këtë:

#### VENDIM

Për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e borës në Llanishtë, të fermeres Ramize Axhami, në vlerë 1,512.00 € /Lënda: 01Nr. 320/01-4373/26.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Propozim Vendimin 10.2 e shtroj në votim për aprovim, rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Prezentë 20. Konstatohet se Kuvendi i Komunës merr këtë:

#### VENDIM

Për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e borës në Stagovë, të fermerit Hajdin Teneqjanë, në vlerë 420,00€/Lënda: 01Nr. 320/01-438426.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Propozim Vendimin 10.3 e shtroj në votim për aprovim, u aprovua njëzëri Për. Prezentë 20. Konstatohet se Kuvendi i Komunës merr këtë:

### VENDIM

Për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit mbi vlerësimin e dëmëve të shkaktuara nga reshjet e shiut në Bob, të fermerit, në vlerë 768,00€ Heset Kuka/Lënda:01Nr. 320/01-4390/26.

11. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin: uk u paraqit kush për diskutim, atëherë e shtroj në votim për aprovim, u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Konstatohet se Kuvendi i Komunës merr këtë:

### VENDIM

Për Arovimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026/ Lënda: 01Nr. 60/01-3665/26.

12.Kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës - AKK, për emërimin e delegatëve në Kuvendin e AKK;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Një anëtarë duhet të jetë nga PDK dhe një anëtarë nga LVV. E hapi diskutimin;

**z. Bashkim Krasniqi:** Nga PDK, e propozojmë për anëtar të AKK, Elona Gjini.

**z. Ernesta Krasniqi:** Nga LVV e propozojmë Kadrije Lika Troni.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Propozimet që dolën, i shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtat u aprovuan njëzëri. Prezentë 20. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

Për delegimin e dy anëtarëve të Kuvendit të Komunës Kaçanik, në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës, si vijon:

1. Elona Gjini anëtare e KK nga subjekti politik i PDK
2. Kadrije Lika Troni anëtare e KK nga subjekti politik i LVV/ Lënda: 01Nr. 60/01-4004/26.

**Në fund,** Kryesuesi i Kuvendit- Selajdin Troni, kërkoj që femrat e përfaqësuara në KK, me formua Grupin Joformal të Grave. Me herët ka qenë i formuar dhe ka funksionuar ky grup i grave.

**znj. Ardita Rrahmani:** Paska pasur kërkesë e nuk e kemi ditur.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kërkesa me ka ardhur me vonesë, vetëm në emailin tim.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë e kam kryesuar GGA të legjislaturës së kaluar, jam shumë e lumtur që gratë kanë qenë shumë bashkëpunuese, deri në vitin zgjedhor. I falënderoj për 2,5 vjet, ndërkaq për vitin e fundit nuk kam falënderim, mbetet në ndërgjegjen e secilës sa kanë punuar. Unë e dorëzoj një Raport në mbledhjen vijuese, pastaj mblidhemi në femrat për formimin e GGA.

**z. Jeton Luma:** Neve që jemi anëtarët e rinj të KK, duhet t 'na informoni për emaillet zyrtare.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora 14:20. Deri në fund të mbledhjes ishin 20 anëtarë, ndërkaq me herët doli, Hafize Sallahi.

**P.S.** (postscriptum-pas shënim) Procesverbali i mbledhjes është hartuar nga Zyrtari i Lartë për Punë të KK, Makfite Malsiu, në bazë të incizimit zyrtarë të mbledhjes dhe shënimeve të procesmbajtëses.

*Malsiu*

Vërtetoj: Kryesuesi i Kuvendit  
Selajdin Troni



30

**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
(të zgjedhur në votimet e datës 12 Tetorit 2025);

**Në mbledhjen e II (dytë) të rregullt të Kuvendit të Komunës,**  
**(Legjislatura e 8 e KK), për vitin 2026, mbajtur me 26.02.2026:**

1. Selajdin Troni.....
2. Blerim Koxha.....
3. Xhelal Ceka .....
4. Brahim Imishti .....
5. Bashkim Krasniqi,.....
6. Lejla Muhaxheri Çaka .....
7. Elona Gjini.....
8. Shqipe Murseli .....
9. Enis Vishi.....
- 10.Kadrije Lika Troni.....
- 11.Ernesta Krasniqi .....
12. Islam Gashi .....
13. Buletin Guri .....
14. Jeton Luma .....
15. Betim Shala .....
- 16.Samedin Rexha,.....
17. Ardita Rrahmani .....
18. Heset Malsiu .....
19. Kijani Zeneli .....
20. Lejla Luta .....
21. Hafize Sallahi,.....



Republika e Kosovës



Komuna Kaçanik

## Drejtoria e Arsimit

---

Për: Anëtarët e Kuvendit: Bashkim Krasniqi

Kjani Zeneli

Kadrije Lika

Lënda: Përgjigje

Të nderuar,

Në përgjigje të pyetjes suaj lidhur me mundësinë e subvencionimit edhe të nxënësve të Shkollës së Mesme të Mjekësisë në Ferizaj, ju njoftoj se subvencionimi aktual realizohet në përputhje me kriteret dhe vendimet në fuqi të Komunës, të cilat janë të orientuara për nxënësit që ndjekin shkollimin në institucionet arsimore publike brenda territorit të komunës sonë.

Qëllimi kryesor i kësaj skeme është ruajtja dhe forcimi i numrit të nxënësve brenda komunës, si dhe mbështetja e drejtpërdrejtë e shkollave tona publike. Për këtë arsye, nxënësit që ndjekin shkollimin jashtë komunës, përfshirë ata në Ferizaj, aktualisht nuk janë të përfshirë në këtë fazë të subvencionimit.

Po ashtu, është me rëndësi të theksohet se Drejtoria Komunale e Arsimit është e penalizuar financiarisht si pasojë e vendimeve gjyqësore që ndërlidhen me pagesat nga Kontrata Kolektive, gjë që ka kufizuar ndjeshëm hapësirën buxhetore për iniciativa dhe masa të reja mbështetëse.

Megjithatë, Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim me Kryetarin dhe Kuvendin Komunal, do të shqyrtojë në të ardhmen mundësinë e zgjerimit të skemës së subvencionimit, në varësi të mundësive buxhetore dhe analizave përkatëse.

Me respekt,

Gazmend Bunjaku

Komuna e Kaçanikut


Drejtor i Arsimit

038 /200-46 438 & 044 224 861

[gazmend.bunjaku@rks-gov.net](mailto:gazmend.bunjaku@rks-gov.net)



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna Kaçanik**  
Opština Kaçanik  
Municipality Kaçanik

<b>DATË/A:</b>	11.03.2026
<b>REFERENC-Ë:</b>	
<b>PËR/ZA/TO:</b>	këshilltarët e Kuvendit Komunal
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Suhad Dullovi, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari <i>Suhad Dullovi</i>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Përgjigjeje në pyetjen e këshilltarit komunal z.Buletin Guri, lidhur me pyetjen për subvencionimin e fermerëve për litër qumështit dhe mungesën e pikës grumbulluese të qumështit në komunën tonë.

Sa i përket pyetjes së këshilltarit komunal z. Buletin Guri, lidhur me pyetjen për subvencionimin e fermerëve për litër qumështit dhe mungesën e pikës grumbulluese të qumështit në komunën tonë.

Sa i përket subvencionimit të fermerëve prodhues të qumështit ( për litër/qumësht), sa për dijeninë tuaj , fermerët prodhues të qumështit të cilët dërgojnë qumësht në pikat grumbulluese subvencionohen nga MBPZHR. Për fermerët që prodhojnë në sasi të vogla e që shesin në treg nuk kemi mundësi subvencionimi, ngase ata shesin në treg me pakicë , për shkak të çmimit më të arsyeshëm dhe nuk kemi parametra matës për sasinë e qumështit të shitur në baza mujore.

Sa i përket mungesës së pikës grumbulluese të qumështi, në komunën ton kemi pasur dy raste të hapjes së pikës grumbulluese të qumështit një herë në fshatin Doganaj, që ka funksionuar për vetëm një javë ngase nuk ka pasur sasi të mjaftueshme të qumështit të dorëzuar dhe u detyruar ta mbyllë. Herën e dytë ka qenë pika grumbulluese në fshatin Nikaj, e që edhe ajo është mbyllur, për mungesë të sasisë së qumështit.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

Data	13.03.2026	Vendi	KAÇANIK
Numri	09	Shtojcë	109/02-6199-1

Kaçanik, 13.03.2026

**Për:** Anëtarët e Kuvendit/ Znj. Ardita Rrahmani

**Lënda: Informim lidhur me emërtimin e palestrës së qytetit në Kaçanik**

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal,

E nderuar znj. Ardita Rrahmani,

Pranojeni përgjigjen dhe sqarimin zyrtarë lidhur me pyetjen/kërkesën tuaj të parashtruar në Kuvendin e Komunës më date 26.02.2026 lidhur me çështjen e emërtimit të Palestrës Sportive. Ju njoftojmë se duke pasur parasysh rëndësinë institucionale dhe publike të kësaj çështjeje, vlerësojmë se është e nevojshme që emërtimi i palestrës të trajtohet përmes procedurave të rregullta institucionale dhe të diskutohet në Kuvendin e Komunës, në mënyrë që vendimi përfundimtar të merret nga organi më i lartë vendimmarrës i komunës, në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin në fuqi dhe njëkohësisht duke e vlerësuar transparencën për këtë vendim.

Gjithashtu, ju informojmë se në kuadër të Komunës funksionon Komisioni për Emërtimin e Rrugëve, Institucioneve dhe Hapësirave Publike, i cili është organi përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve që kanë të bëjnë me emërtimin e objekteve dhe hapësirave publike. Ky komision ka për detyrë të analizojë propozimet, të marrë parasysh kriteret ligjore, historike dhe shoqërore, si dhe të japë rekomandime përkatëse para se çështja të procedohet për vendimmarrje në Kuvendin e Komunës.

Në këtë proces, edhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport do të japë kontributin e saj profesional duke ofruar rekomandime lidhur me këtë çështje, me qëllim që vendimi përfundimtar të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe në interes të komunitetit.

Për këtë arsye, çdo propozim lidhur me emërtimin e Palestrës Sportive do të trajtohet fillimisht nga komisioni përkatës, i cili më pas do të paraqesë rekomandimet e tij për shqyrtim dhe vendimmarrje në Kuvendin e Komunës.

Për çdo vendim që do të merret lidhur me këtë çështje, opinioni publik dhe Kuvendi i Komunës do të njoftohen me kohë dhe në mënyrë transparente.

Me respect!



Lulzim Krasniqi

Drejtor i DKRS



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



Kaçaniku  
Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

Data	13.03.2026	Vendi	KAÇANIK
№. org.	09	Numri	109/02-6200-1
		Shtojcë	

Kaçanik, 13.03.2026

**Për:** Anëtarët e Kuvendit/ Z. Islam Gashi

**Lënda: Informim lidhur me ndërtimin e terrenit sportiv rekreativ në fshatin Begrac**

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal,

I nderuar z. Islam Gashi,


Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Kaçanikut informon qytetarët se është paraparë ndërtimi i një terreni sportiv rekreativ në fshatin Begrac, në kuadër të planifikimeve zhvillimore të kësaj Drejtorie.

Ky projekt është pjesë e prioriteteve të komunës për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës sportive, me qëllim të krijimit të hapësirave të përshtatshme për aktivitete sportive dhe rekreative për të rinjtë dhe banorët e komunitetit lokal.

Në përputhje me planifikimet strategjike dhe mundësitë buxhetore të Komunës së Kaçanikut, realizimi i këtij projekti pritet të bëhet brenda mandatit aktual qeverisës, duke respektuar procedurat ligjore dhe administrative në fuqi.

Me respekt,



  
Lulzim Krasniqi  
Drejtor i DKRS



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna Kaçanik**  
Opština Kaçanik  
Municipality Kaçanik

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit

DATË/A:	17.03.2026
REFERENC-Ë:	06-350/02-5772 dt.05.03.2024
PËR/ZA/TO:	Makfire Malsiu - zyrtare e Kuvendit Komunal të Kaçanikut
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Korab Krasniqi - Drejtor i DUKMM 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje në Kërkesën e datës 05.03.2024 nga asambleistja Kadrije Lika-Troni

Të nderuar,

Duke ju referuar kërkesës tuaj me nr.protokoli 06-350/02-5772 të datës 05.03.2024, ju njoftojm se sipas gjendjes aktuale:

- Parcela kadastrale nr. 00135-3 me sipërfaqe prej 208.7 m<sup>2</sup> me kulturë rrugë private e evidentuar në emër të ½ Nesret (Ruzhdi) Troni dhe ½ Nazim (Ruzhdi) Troni në zonën kadastrale Kovaçec, është e hipotekuar në bankën NLB PRISHTINA SH.A. sipas Kontratës Vr.nr.933/03 dt.08.06.2009 .

Andaj për bartjen e kësaj prone në emër të Komuna e Kaçanikut duhet të bëhet së pari shlyerja-fshirja e hipotekës dhe më pas të vazhdohet me procedurat të parapara sipas ligjit në fuqi.

Gjithashtu dhe pronarët e parcelave kadastrale nr. 134-3; 156-3 853-3 dhe 851-2 duhet të jenë të gjithë gjallë dhe që personalisht të vijnë dhe japin Deklaratë për heqje dorë nga pronësia e tyre lidhur me këto parcela dhe të njejtat ti barten në emër të Komuna e Kaçanikut sipas Ligji Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drajtat Tjera Sendore – Neni 42 Paragrafi 1 dhe 2.

Me kompletimin e këtyre procedurave dhe bartjen e pronës në emër të Komuna e Kaçanikut më pas mund të vazhdohet me veprimet e kërkuara sipas kërkesës suaj për asfaltimin e rrugës.

Me respekt,




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna Kaçanik**  
Opština Kaçanik  
Municipality Kaçanik

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit

<b>DATË/A:</b>	24.03.2026
<b>REFERENC-Ë:</b>	
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Anëtarët e kuvendit
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Makfire Malsiu - zyrtare e Kuvendit Komunal të Kaçanikut
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Korab Krasniqi - Drejtor i DUKMM 
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Përgjigje në Kërkesën e datës 26.02.2026 nga asambleisti z. Hesel Malsiu

Të nderuar,

Duke ju referuar pyetjes tuaj gjatës seancës së datës 26.02.2026 ju njoftoj se :

- Ne kemi pranuar kërkesë edhe zyrtarisht për këtë qështje dhe jemi në shqyrtim të saj.
- Ne si drejtori ju kemi ofruar bashkëpunim dhe në momentin që kemi mundësi financiare, do të realizojmë këtë projekt.

Me respekt,



**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCËS**

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

<b>DATA:</b>	<b>24.03.2026</b>
<b>PËR/ZA/TO:</b>	<i>KUVENDIN KOMUNAL-KAÇANIK</i>
<b>CC:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	<b>Arian TENEQJA</b>  <i>Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës</i>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Përgjigje ndaj kërkesës nga anëtarja e Kuvendit</b>

Lënda: **Përgjigje ndaj kërkesës nga anëtarja e Asamblesë Komunale- Kadrije Lika Troni**

**Kadrije Lika Troni:** I bashkëngjitëm kolegëve, pyetjet dhe kërkesat ti pranojmë nga zyrtarja e KK, për me ditur përgjigjen të gjithë, e jo me qenë kontakti drejtor- anëtar i KK. I kam dy kërkesa për, DSHPE dhe DA. Na gëzon fakti që kryetari Sabedin Vishi ka realizuar disa kërkesa tona të ngritura në mandatin e kaluar.

2. Kërkesë për pastrimin e lumenjve, sidomos lumit lepenç, pjesa të ura ku frekuentohet nga shumë vizitorë të qyteteve tjera, pasi në njërin anë është, Palestra sportive në anën tjetër Stacioni i autobusëve, kërkesë kjo të cilën e kam ngritur edhe në mandatin e kaluar, nuk është marrë asgjë. Ekziston një pemë të ura, ku i janë dashur vite të tëra me lëshuar rrënjë nga lumi dhe zhvillimi i saj ka arritur të kaloj mbi urë. Kërkoj nga ekzekutivi, DSHPE të merr parasysh këtë kërkesë.

**Përgjigje:** Pastrimi i shtretërve të lumenjve në zonën urbane është përgjegjësi e komunës. Drejtoria e Shërbimeve Publike, në bazë të kontratave që ka për mirëmbajtje, bën rregullisht pastrimin e këtyre segmenteve të zonës urbane, varësisht nga prurjet e lumenjve që vijnë nga reshjet, rritja e vegetacionit në shtrat etj.

Pjesa të cilën e keni kërkuar do të pastrohet në ditët në vijim. Kemi pritur vetëm që të bjerë niveli aktual i lumit për të filluar me pastrimin. Në këtë kohë që po flasim, pastrimi i këtij segmenti vetëm se ka filluar.

Ju faleminderit.